



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Lindita DHAMO
2. Dr. Miranda HARIZAJ

Shtator/2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”

1	IAL aplikues:	Universiteti “EPOKA”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë (Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr.269 datë 28/06/2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 25, datë 12/3/2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr.435 datë 25/08/2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit viti akademik 2021-2022:	7 PAE / 1 PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezultojnë: 86 % PAE / 14 % PAK
18	Numri i studentëve 2016-2022:	52 student
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti EPOKA ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2009 -2010, pas liçensimit të tij me VKM Nr.281, datë 12.03.2008. Me Urdhrin Nr. 260, datë 07.06.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është realizuar akreditimi i parë për institucionin e organizuar si më poshtë:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financë-Bankës
- Departamenti i Administrim Biznesit

3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Departamenti i Drejtësisë
- Qendra për Studime Europiane

Programi është në varësi të Departamentit të Shkencave Kompjuterike.

IAL ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Vendimin Nr.92, datë 20.10.2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Universiteti "EPOKA" ka realizuar riakreditimin institucional Vendim BA Nr. 54, datë 16.12.2021 me një afat vlefshmërie 6 vite.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, UMASH Nr. 269, datë 28.06.2012, me emërtimin: Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni". Akreditimi i parë i këtij programi studimit është finalizuar me Nr. 435 datë 25.08.2016. Aktualisht programi i studimit ka hyrë në procesin e ri-akreditimit. Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër i QSHA Nr. 25, datë 12.3.2018.

Kohëzgjatja e tij normale është 2 vite dhe numri krediteve të tij është 120 ECTS. Programi zhvillon mësimdhënien në gjuhën angleze.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të procedurave për ri-akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni", të ofruar nga Universiteti EPOKA.

Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

REKOMANDIMI

a) Institucioni duhet të sigurojë kushtet e nevojshme dhe mbështetjen financiare të dedikuar për zhvillimin e aktivitetetve të kërkimit shkencor në funksion të realizimit të këtij programi studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), duke u mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), vizitën në institucion si dhe plan-programin e programit të studimit shpreh mendimin se institucioni i ka përmbushur rekomandimin e Këshillit të Akreditimit si më poshtë:

Rekomandimi: Institucioni duhet të sigurojë kushtet e nevojshme dhe mbështetjen financiare të dedikuar për zhvillimin e aktivitetetve të kërkimit shkencor në funksion të realizimit të këtij programi studimi.

GVJ: Institucioni ka ofruar mbështetjen financiare të rregulluar nga direktiva "Për nxitjen e kërkimit shkencor" ku çdo punonjësi të Universitetit EPOKA i jepet mbështetje financiare bazuar në cilësinë e revistës ku publikohet punimi kërkimor dhe në respekt të pronësisë intelektuale të IAL. Institucioni ka ofruar kushtet e nevojshme për kërkim shkencor duke ofruar pajisje të cilësisë së lartë në laboratorin Elektronik dhe hapësirë në dispozicion sipas nevojës. DIK dhe stafi akademik është angazhuar dhe ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe publikuar punime shkencore me faktor të lartë impakti dhe në revista prestigjioze, me mbështetjen financiare të IAL. Në të njëjtën kohë është angazhuar vazhdimisht me pjesmarrje në projekte kombëtare e ndërkombëtare për sigurimin e infrastrukturës bashkëkohore laboratorike.

Bazuar në vlerësimin e mësipërm e konsiderojmë **të përmbushur** këtë rekomandim.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ

Dr.Lindita DHAMO

Dr. Miranda HARIZAJ

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr.30, Datë 18.03.2022 “Urdhër Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, për akreditimin e programeve, Universiteti Epoka”, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të parë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti “Epoka”, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” e përbërë nga 230 dokumenta në total.

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” kanë realizuar vizitën në datën 22 Prill 2022 në Universitetin “Epoka”, sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët.

Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standardeve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Epoka”.

Koordinator teknik i procedurës nga ASCAL është Msc. Aviola Bardhi.

Më datë 01./08.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 29/36 Prot., datë 01.08.2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 29.08.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr 96/3 Prot., datë 29.08.2022.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në FUSHA I – Standardi I.2 - Kriteri 3 - Fq.13: Nuk ka rregullore specifike për programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”. UE ka një rregullore për programet e ciklit të dytë, në përgjithësi të vlefshme për të gjitha programet e studimit të këtij niveli. Kjo rregullore nuk ka emërtimin specifik (sepse është tip), por formuese.

Komente nga GVB: Dëshirojmë t’Ju informojmë që për programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” ka një rregullore por është e pa përditësuar, lutemi gjeni bashkëngjitur dokumentin (Aneksi 1: Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni).

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 6

Deri më tani, ne u jemi referuar rregullores së institucionit mbi programet e ciklit të dytë. Kjo rregullore e institucionit rregullon të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, duke reflektuar ndryshimet dhe përditësimet e legjislacionit të ministrisë përgjegjëse së arsimit të lartë. Gjithashtu, ju informojmë rregulloria në fjalë do të përditësohet gjatë vitit akademik 2022-2023.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e UE u paraqit rregullorja e programit të studimit, që është në proces përmirësimi.

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA I – Standardi I.3 - Kriteri 2 - Fq.14: UE nuk ka paraqitur në dosjen e vlerësimit një studim tregu lokal ose ndërkombëtar të punës për programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përpara hapjes së tij, ose pas daljes së studentëve të brezave të ndryshëm dhe në mënyrë periodike.

Komente nga GVB: Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përgatit studentët si ne nivelin bachelor edhe në atë master me aftësi të mira në njohjen me detaje të komponentëve elektronike, në integrimin e tyre në sisteme të integruara, si edhe në programimin dhe kontrollin e këtyre sistemeve. Keto aftësi janë shumë të kërkuara në tregun e punës dhe kjo është vërtetuar nga shkalla e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi. Përveç kësaj studentet e Masterit Shkencor janë angazhuar dhe kanë plotësuar me sukses detyra shumë të vështira në Projektet Horizon 2020 Kërkim dhe Inovacion (shembull PANBIORA). Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike që mbështet këtë program studimi ka qenë i vetmi institucion që ka qene përgjegjës i vetem ne konsortiumin prej 17 institucionesh për zhvillimin e disa komponenteve me precision të lartë në këtë projekt, dhe ja ka arritur me sukses. Kjo është një tregues se aftësite që përftohen në këtë program studimi janë të përshtatshme jo vetëm për tregun e punës ku kryesisht kërkohet implementimi i teknikave egzistuese, por janë të përshtatshme edhe me programet kërkimore të nivelit të doktoraturave të universiteteve me të mira në botë ku keto teknika zhvillohen përtej niveleve aktuale.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.1 - Kriteri 2 - Fq.22: Ky lloj organizimi i kurrikulës nuk është zbatuar strikt sipas VKM.41 datë 24.01.2018, ku përveç numrit total të ECTS dhe kushtit që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”, kriteret e tjera nuk plotësohen. Nga kategoria C (lëndët ndërdisiplinore) nuk kemi asnjë lëndë. Gjithashtu vihet re se kurrikula në kategorinë B (lëndët karakterizuese) janë në 70% të pacaktuara. Kjo mund të sjellë një farë fleksibiliteti për

realizimin e programit të studimit sipas kërkesave e mundësive, por gjithsesi mbetet i pacaktuar.

Komente nga GVB: Lidhur me konstatimin e GVJ për Standardi II.1, Kriteri 2, GVB e vlerëson dhe shpreh që ndryshimet përkatëse të konstatuara janë pjesë e planit të ndryshimeve në kurrikulën e programit për tu vënë në zbatim në vitin Akademik 2022- 2023, sipas VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.1 - Kriteri 7 - Fq. 24: Diploma disponon 30 ECTS, përbën 25% të planit mësimor, nga 10-15% që parashikon VKM.41 për këtë veprimtari formuese. Syllabusi për lëndën "Diploma" detajon aktivitetet kërkimore për zhvillimin e saj. DVV Evidencë: ECE 500 course changed

Komente nga GVB: Lidhur me konstatimin e GVJ për Standardi II.1, Kriteri 7, GVB e vlerëson dhe shpreh që ne do të adaptojmë kurrikulën sipas VKM 41, datë 24.01.2018.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.3 - Kriteri 7 - Fq.29: Nga biseda me stafin akademik u konkludua se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. Nga verifikimi i syllabuseve që kanë ndryshime, vihet re se: 1) Për lëndën Metoda Numerike të Avancuara, ndryshimi i programit lëndor është tërësor, dhe jo në masën 20% siç parashikon ligji. 2) Për lëndët e tjera nuk ka ndryshime. 3) Në disa syllabuse nuk jepet informacion për vitin e botimit të literaturës së rekomanduar për studentët. 4) Literatura e rekomanduar, në rastet e pakta kur është vendosur viti i botimit, nuk është e 5 viteve të fundit.

Komente nga GVB: 1) Vërejtja për lëndën 'Metoda Numerike te Avancuara' është me vend dhe ne do ta rishikojmë me kujdes. Duam të përmendim se një ndryshim qe shfaqet në dy silabuse të dy semestrave të njëpasnjëshëm, përmbajtja është kryesisht e përbashket. Si shembull, mund të përmendim se nëse në versionin e fundit përmendet problemi ku do të implementohet një metodë numerike (zgjidhja e ekuacionit te lavjerresit), në silabusin e mëparshem është përmendur teknika që e zgjidh këtë problem (derivimi numerik).

2) Ne do të përditesojmë silabuset me literaturën kryesore dhe mbështetese me tekste të pesë viteve të fundit.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.4 - Kriteri 5 - Fq.31: Aktivitetet trajnuese përmes praktikave vullnetare, praktikës profesionale, seminareve, e lehtësojnë arritjen e objektivave të mësimdhënies, transferimin e studimeve, lëvizshmërinë dhe punësimin në fund të programit të studimit të përcaktuar në kurrikul dhe të shpallur në faqen e internetit të departamenti. GVJ Sugjeron që: 1) Kurrikula të rishikohet dhe të parashikojë si lëndë të veçantë “Praktikën profesionale”, minimalisht 10 ECTS. 2) Gjithashtu tek syllabuset të specifikohet hapësira që i lihet Laboratoreve. 3) Syllabuset duhet të kenë të përcaktuara temat e detyrave të kursit 4) Syllabuset duhet të kenë të përcaktuara temat e punëve laboratorike DVV Evidencë: Annex 20, Course Syllabus

Komente nga GVB: Lidhur me konstatimin e GVJ për Standardi II.4, Kriteri 5, GVB e vlerëson dhe shpreh që ndryshimet përkatëse të konstatuara janë pjesë e planit të ndryshimeve në kurrikulën e programit për tu vënë në zbatim në vitin Akademik 2022- 2023. Ndryshimet në kurrikul parashikojnë ofrimin e Praktikës Profesionale në planin mësimor sipas VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Gjithashtu, në të gjitha lëndët e programit të studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, studentet realizojnë projekte të cilat kanë një nivel të caktuar vështirësie. Silabusi do të pajiset me më shumë detaje, ku do të përfshihen edhe temat e punëve laboratorike dhe të detyrave të kursit.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.7 - Kriteri 1 - Fq.37 Statuti i Universitetit EPOKA përcakton prioritetet dhe objektivat kryesorë të Programeve të studimit që ofron. Prioriteti më i lartë mbetet kërkimi shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto prioritete dhe objektiva do të shpreheshin më qartë e me detaje nëse Departamenti do të kishte rregullore të veçantë për çdo program studimi. DIK nuk ka rregullore specifike për programin e studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion. Veprimtaria e këtij programi studimi bazohet tek rregullorja tip që UE ka për programet e studimit të ciklit të dytë. DVV Evidencë: Annex 2, Statuti i UE Annex 13, Rregullorja e PS të ciklit të dytë

Komente nga GVB: Dëshirojmë t'Ju informojmë që për programin e studimit Master i shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" ka një rregullore por është e pa përditësuar, lutemi gjeni bashkëngjitur dokumentin (Aneksi 1: Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni").

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/ sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.4 - Kriteri 2 - Fq.71 GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdimësi të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.

Komente nga GVB: Në çdo semester, çdo kolegu në department i kërkohet që të përgatisë një listë me tekste të cilat mund të blihen për të pasuruar librarinë. Ne do ta vazhdojmë këtë praktike, për të përmbushur këtë sugjerim të GVJ.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.6 - Kriteri 5 - Fq.77 GVJ rekomandon që IAL të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.

Komente nga GVB: Ne si departament i Inxhinierise Kompjuterike do të eksplorojmë mundësi të ndryshme për financimin e këtij programi studimi. Si psh, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA VI – Standardi VI.5 - Kriteri 5 - Fq. 108 GVJ rekomandon që IAL duhet të organizojë veprimtari periodike trajnuese dhe informuese me personelin dhe studentët për t'i informuar për nevojën e ndergjegjësimin të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit, përfshi programin e studimit Master i shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni".

Komente nga GVB: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin Epoka ka organizuar rregullisht sesione trajnimi për stafin dhe studentët për përmirësimin e cilësisë.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10

1. Shumë nga këto programe mund të gjenden në faqen e webit të kësaj njësie.
2. Bazuar në këtë sugjerim të GVJ, ne do të vazhdojmë të organizojmë veprimtari trajnuese për stafin dhe studentët.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.



Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”

1. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË “INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKACIONI”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit, gjë e cila reflektohet në Statutin e Universitetit “EPOKA”, Tiranë (UE).</p> <p>Në Statutin e UE, neni 3, shprehet qartë se misioni i Universitetit “EPOKA” konsiston në të qenit një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave thelbësore njerëzore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri shoqërore, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me qëllim të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.</p> <p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Një tregues domethënës në plotësimin e misionit të IAL është pjesëmarrja në platformën U-Multirank.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 2</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në Statutin e UE, neni 3 shkruhet se “UE synon të mundësojë studime akademika të thelluara, duke e orientuar kërkimin shkencor drejt fushave të saj të studimit duke përfshirë në programet mësimore e studimore traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të gërshetuara me standartet dhe arritjet më të mira botërore përgjithësisht etj.”</p> <p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” që ofrohet nga UE synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidencë: Aneks 2</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” që ofrohet nga UE ka mision të ofrojë programe studimi në fusha studimi të ndryshme, referuar niveleve 6, 7, 8 të Kornizës</p>

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Shqiptare të Kualifikimeve, sipas fushave specifikuar në Statut UE neni 3. Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” është program i nivelit 7 të KSHK. <i>DVV Evidencë: Aneks 2</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	UE ka mision të ofrojë programe studimi për formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkenctarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, Statuti UE, neni 3. UE ka mision të ofrojë shërbime me ndikim në publik dhe në komunitet, si dhe shërbime për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, Statuti UE, neni 3. <i>DVV Evidencë: Aneks 2</i>			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” që ofrohet nga UE synon kualifikimin në vazhdimësi dhe bashkëkohor të stafit akademik duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor. Statuti UE, neni 3. <i>DVV Evidencë: Aneks 2</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	UE ka përcaktuar në Strategjinë 2018 – 2022, prioritetet në lidhje me zhvillimin e IAL në të gjitha nivelet. Drejtimit kryesorë të fokusit janë: garantimi i cilësisë në fushat e kërkimit shkencor e mësimdhënies, menaxhimit institucional dhe të programeve të studimit në të gjitha nivelet. Kurrikulat ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut, për t’i pajisur dhe aftësuar studentët me njohuri që u lehtësojnë qasjen në tregun kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. <i>DVV Evidencë: Aneks 81</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në	Misioni UE: a) ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional, referuar niveleve 6, 7, dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

<p>përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UE neni 11,12,13, UE në përputhje me objektivat e saj, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhenies dhe në respektimin e lirisë së secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurren me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar.</p> <p>1. Fakultetet, departamentet dhe Qendra Kërkimore Shkencore ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme dhe miratojnë kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, sipas propozimeve të njëjësive bazë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore.</p> <p>2. Fusha specifike e secilës njësi kryesore përcaktohet në rregulloren e universitetit.</p> <p>3. Disiplinat mësimore, fushat e kërkimit shkencor dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e universitetit.</p> <p>4. Në UE programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë hartohen dhe propozohen nga njësia baze dhe Qendra Kërkimore Shkencore, sipas nevojave dhe specifikës së çdo fushe përkatëse.</p> <p>Drejtimet prioritare akademike të tij përcaktohen në rregulloren e UE.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 2</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>UE ka paraqitur një rregullore specifike shtesë për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion. Kjo rregullore ka emërtimin specifik dhe paraqet: qëllimin dhe objektivat, strukturën e këtij programi studimi me lëndët dhe kreditet përkatëse. Jepen dhe kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin e studimit dhe ndarja në kredite sipas lëndëve. Përmbajtja e programit të studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” dëshmon se është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UE dhe Departamentit përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Komente për draftin, rregullorja: Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 2</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” është hartuar në përputhje me misionin e UE që të jetë IAL ndikuese në zhvillimet kombëtare, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, në shërbim të interesit kombëtar dhe përditësimin e kurrikulës për ndjekjen e trendeve globale të zhvillimit në fushat e saj të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 2</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” ka objektiva të përcaktuar në Statutin e UE Neni 3 për formimin e studentëve në të gjitha programet që ky universitet mbulon, ku përfshihen njohuri të thelluara shkencore, specialist të nivelit të lartë “senior”, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato. Këto përcaktime mbeten në terma të përgjithshëm sepse diskutimi për këtë çështje është në nivel universiteti. Ky program studimi ka synim krijimin e kompetencave profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 2</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p><i>UE nuk ka paraqitur në dosjen e vlerësimit një studim tregu lokal ose ndërkombëtar të punës për programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përpara hapjes së tij, ose pas daljes së studentëve të brezave të ndryshëm dhe në mënyrë periodike.</i> Sipas bisedës me Përgjegjësën e Departamentit DIK, zhvillimi i qëndrueshëm i këtij programi studimi garantohet nga trendi i lartë i kërkesës së tregut për këtë lloj profesioni si në planin rajonal ashtu edhe kombëtar. Gjithashtu në Guidën e Studentit deklarohet një shkallë punësimi 90% e të diplomuarve tek UE në tregun kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 72</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” me objektivat formues e strukturën e PS, shprehur në Statut dhe Rregulloren e PS të nivelit të dytë edhe pse në terma të përgjithësuar, garantojnë përftimin e dijeve përmes kujdesit për rekrutim stafi akademik të kualifikuar, rritjen e aftësive profesionale të përditësuara përmes nxitjes së kërkimit shkencor tek stafi dhe studentët, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>

	<i>DVV Evidencë: Aneks 2, Aneks 69</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” ka strukturë dhe kurrikul që i mundëson të përafrohet lehtë me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare. Kjo lehtëson transferimin e studimeve në IAL Brenda ose jashtë vendit apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	Programi i studimit (PS) Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin shqiptar në fuqi për arsimin e lartë dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, legjislacion që referohet në <i>Statutin e UE Neni 1</i> . PS mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. <i>DVV Evidencë: Aneks 2</i>
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përfshin në planin mësimor aftësimin profesional përmes zhvillimit të praktikave laboratorike në ambientet e institucionit, në përputhje me syllabuset e lëndëve. <i>Praktika profesionale nuk përfshihet si lëndë e veçantë në planin mësimor për programin e studimit në shqyrtim.</i> Gjithsesi në nivel institucional ky aktivitet mësimor bëhet i përputhur me qëllimin dhe objektivat e programit të studimit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Në mbështetje të kësaj veprimtarie, në nivel institucioni ka një Udhëzues Praktike të unifikuar për të gjithë studentët e UE, me mundësi personalizimi përmes rubrikave të ndryshme ku përveç shpjegimit të termave të references, ky udhëzues përmban edhe formularët që plotësohen prej studentit dhe prej mbikqyrësit të praktikës. <i>DVV Evidencë: Praktika Profesionale (Nr.5)</i>
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Në programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, i gjithë procesi i mësimdhënies zhvillohet në gjuhë të huaj (Anglisht) me qëllim : 1) rekrutimin e studentëve të huaj, 2) mundësinë e studentëve të UE të vazhdojnë studimet e nivelit pasardhës në universitete ndërkombëtare 3) si dhe në rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Për programin studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, UE përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze. I gjithë dokumentacioni i depozituar në dosjen e

	vlerësimit, pjesa më e madhe e dokumentacionit në sekretarinë mësimore etj janë në gjuhën angleze. <i>DVV Evidencë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti EPOKA është një institucion ndërkombëtar i arsimit të lartë i vendosur pranë Aeroportit të Rinasit në Tiranë. Universiteti ka filluar aktivitetin gjatë periudhës akademike 2007-2008 vit në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të arsimit të lartë shqiptar.</p> <p>Universiteti EPOKA ka një staf akademik me kohë të plotë të kualifikuar, 38% e të cilëve janë të huaj që nga shtatori 2019. Stafi i huaj vjen nga SHBA, MB, Rusia, Franca, Italia, Maqedonia e Veriut, Greqia, Kosova, Turqia, Azerbajxhani, Indonezia dhe Pakistani. Gjatë v.a 2018-2019, raporti student/ pedagog ishte 19: 1.</p> <p>“Ndërkombëtarizimi” përfaqëson një objektiv strategjik të Universitetit EPOKA. Në këtë kontekst, Universiteti EPOKA është një universitet aktiv në Shqipëri që zhvillon programe shkëmbimi studentësh dhe stafi me universitete të huaja. Për më tepër, Universiteti EPOKA bashkëpunon me BE-në universitetet përmes Programit Erasmus+ në kërkime dhe projekte me synim mbështetjen e veprimeve në fushën e shkëmbimit të stafit dhe studentëve.</p> <p>Universiteti EPOKA ka përfutur nga programi TEMPUS, financuar nga Bashkimi Evropian. Universiteti EPOKA është aktualisht një institucion partner për 3 projekte Erasmus+ KA 2, Projektet e Ngritjes së Kapaciteteve dhe një projekt Horizon 2020, i cili është i pari një projekt i tillë në Shqipëri dhe ku janë aktivë studentë nga programi I studimit janë përfshirë.</p> <p>Biblioteka Universitare EPOKA ofron akses të ndryshëm për studentët e saj nëpërmjet Bibliotekës Dixhitale në lidhje me të gjitha studimet programore të ofruara nga EPOKA. Biblioteka është e abonuar në disa burime elektronike si Science Direct e Elsevier, JSTOR, IOPscience, SCOPUS, Taylor dhe Francis, OECD-Library dhe Cambridge Journals Online.</p> <p>Kampusi i Universitetit EPOKA ndodhet në një zonë të gjelbër jashtë qytetit të Tiranës dhe ofron ambiente me komoditet dhe infrastrukturë IT, me shërbime dhe lehtësira për studentët, stafit dhe palëve të tjera të</p>

	<p>interesuara dhe që përfshin tre laboratorë kompjuterikë, një elektronik dhe një inxhinieri ndërtimi.</p> <p>Universiteti EPOKA deklaron një shkallë punësimi prej rreth 90% për të diplomuarit e tij, të cilët janë të punësuar në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të punës. Krahas infrastrukturës dhe objekteve të pajisura mirë, Universiteti EPOKA ofron praktika, rrjetëzim, panairë karriere dhe mundësi punësimi për studentët dhe të diplomuarit e tij në bashkëpunim me sektorët dhe industrinë në kuadër të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p><i>DVV Evidencë: Evidencat Nr. 134-138: Raportet vjetore UE 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit sipas parashikimeve të nenit 86 të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” nuk është miratuar ende nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Megjithatë, Universiteti EPOKA zbaton kodifikimin e programeve dhe kurseve të studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex Nr.20 Course Syllabus, Evidencat 139-149: Ndryshimet e syllabuseve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinor, lëndët/ kurset ofrohen nga njësi bazë të ndryshme dhe çdo lëndë ruan kodin e njësisë bazë përkatëse. Kodifikimi kombëtar nuk është miratuar ende nga MASR, por Universiteti EPOKA zbaton kodifikimin e programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex 2: Statute of UE</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka një plan strategjik në nivel institucional si dhe një në nivel departamenti për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” dhe përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit. Në baza vjetore, Institucioni rishikon ecurinë e programit të studimit bazuar në bazën e të dhënave të vlerësimit të departamentit që përmban tregues të performancës për mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe përgjegjshmërinë ndaj shoqërisë, bazuar në raportin vjetor dhe çdo masë strategjike shtesë. Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit duke u ngarkuar detyra njësisve dhe personelit që marrin përgjegjësitë përkatëse. Disa borde janë të përbëra nga personel akademik nga departamente të ndryshme.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 3, Aneks 6</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti EPOKA, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe zyra e Alumni ka rreth 33 marrëveshje bashkëpunimi me Institucione dhe Organizata vendase dhe të huaja (institucionet shtetërore, organizatat profesionale, komuniteti i biznesit, tregu i punës dhe aktorë të tjerë socialë të rëndësishëm për arsimin e lartë) për të mbështetur trajnimin, praktikave dhe mësimdhënien e studentëve. Zbatimi i njohurive të marra gjatë procesit mësimor, do t'u mundësojë studentëve të lidhen me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Organizimi i praktikave profesionale për studentët në institucione të ndryshme publike si dhe në kompani private brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryhet kryesisht gjatë sezonit veror. <i>DVV Evidencë: Aneks 7</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh të lidhura me institucione IAL Brenda e jashtë vendit, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit etj. Në raportet vjetore të institucionit ka të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të të gjitha programeve të studimit. Fakti që studentët e këtij programi studimi janë pothuajse 100% të punësuar, tregon se këto marrëveshje janë efektive.</p> <p><i>DVV: Aneks 5, Raporti Vjetor UE</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit në lidhje me përfundimin dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit.</p> <p>Ka 48 marrëveshje që lidhen me këtë program studimi që bëjnë të mundur që studentët të kryejnë një praktikë, trajnime etj.</p> <p>Në rastin e praktikave profesionale që mundësohen me mbështetjen e zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Alumni, zyra kërkon nga kompanitë të japin një certifikatë që tregon se studenti ka përfunduar praktikën dhe një vlerësim të përgjithshëm për studentin.</p>

	<i>DVV Evidencë: Aneks 7</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	<p>UE ofron trajnime profesionale për të diplomuarit në koordinim me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë nga akademia dhe industria. Shembuj të studentëve të M.SH në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni janë:</p> <p>i) Vizita e trajnimit në Shkollën e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Studimeve të Aplikuara (Beograd, Serbi);</p> <p>ii) Shkolla Verore Ndërkombëtare: Studime të Avancuara mbi Biometrikën për Autentifikim të Sigurt në Alghero, Itali;</p> <p>iii) Shkolla Verore Ndërkombëtare për Arkitekturën e Avancuar të Kompjuterit dhe Kompilimin për Sisteme me Performancë të Lartë dhe Embedded (ACACES) në Fiuggi, Itali;</p> <p>iv) Shoqëritë vendase të themeluara në Tiranë, Shqipëri etj.</p> <p>Klubet e Studentëve janë një mekanizëm që Institucioni dhe programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” zbaton për të zhvilluar më tej aftësitë e studentëve dhe të diplomuarve në koordinim me industrinë duke sjellë aktivitetet në përputhje me nevojat e tyre (klubi robotik, brenda laboratorit).</p> <p><i>(http://clubs.epoka.edu.al/)</i></p> <p><i>(http://clubs.epoka.edu.al/robotics-club/)</i></p>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	<p>Departamenti harton raporte periodike analitike, që bëhen pjesë e raporteve vjetore të UE. Në paragrafin për performancën e shkollimit në UE, që analizohet përmes të dhënave të punësimit, jepet informacion për punësimin e studentëve sipas programeve të studimit duke treguar përfitimet prej marrëveshjeve të bashkëpunimit për të përmirësuar programin e studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”. Në lidhje me performancën e të diplomuarve në kuadër të profesioneve të rregulluara nuk jepet informacion.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore	Çdo aktivitet publikimi dhe rezultat kërkimi shkencor që shpërndahe nën siglën e UE, përmes: faqeve të internetit të Universitetit EPOKA, Zyrës së Kërkimeve dhe Projekteve, përmes faqeve zyrtare të mediave sociale të Universitetit EPOKA, vlerësohet me një bonus në pike që përkthehet më pas në shpërblim monetar për autorët pjesë e stafit akademik PAE, PAK ose

shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	student. Kjo politikë jo vetëm që mbështet por edhe motivon stafin akademik dhe studentët të përfshihen në veprimtari kërkimore e shkencore. <i>DVV Evidencë: Aneks 9</i>								
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në nenin 35 të Statutit të Universitetit EPOKA, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitet. Ky komision funksion në nivel institucioni me anëtarë nga çdo fakultet. Gjithashtu, UE ngre çdo vit akademik Komisionin e Promovimit dhe Mbështetjes së Aktiviteteve Shkencore që është themeluar me qëllimin e vlerësimit të cilësisë së aktivitetit shkencor dhe promovimin e tij. Kur ky komision nuk ngrihet, aktiviteti i tij kryhet nga Rektori. Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve (RPO) promovon nivelin e angazhimi në kërkime ndërmjet stafit akademik dhe cilësinë e rezultateve të kërkimit të prodhuar. <i>DVV Evidencë: Aneks 2, Aneks 9</i>								
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Universiteti EPOKA ka një udhëzim të shkruar dhe të botuar me titull: "Për promovimin e botimeve shkencore" që përcakton principet dhe metodat e inkurajimit të stafit akademik e studentëve në aktivitetet shkencore e botimet. Ky dokument përcakton qartë me sistem pikëzimi bonusin që përfitohet sipas cilësisë së botimit. <i>DVV Evidencë: Aneks 9</i>								
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	UE mbështet financiarisht stafin akademik dhe studentët që botojnë nën siglën e Universitetit EPOKA dhe kërkon prej autorëve që të shprehen në lidhje me financimin. Kjo politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale është një praktikë e mirë edhe në veprimtarinë kërkimore-botuese në ILA brenda e jashtë vendit. <i>DVV Evidencë: Aneks 9</i>								
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor .përmes Zyrës së Kërkimeve dhe Projekteve (RPO) mundëson ndërtimin e kapaciteteve kërkimore midis studentëve master dhe t'i motivojë ata për të shpërndarë dhe zbatuar në mënyrë kritike kërkimin shkencor.	UE inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor .përmes Zyrës së Kërkimeve dhe Projekteve (RPO) mundëson ndërtimin e kapaciteteve kërkimore midis studentëve master dhe t'i motivojë ata për të shpërndarë dhe zbatuar në mënyrë kritike kërkimin shkencor.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyset</th> <th>Përmbyset pjesërisht</th> <th>Përmbyset kryesisht</th> <th>Përmbyset plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht				X
Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyset</th> <th>Përmbyset pjesërisht</th> <th>Përmbyset kryesisht</th> <th>Përmbyset plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht				X
Përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht						
			X						

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” në Universitetin EPOKA është një program studimi dy vjeçar, me 120 ECTS, i cili korrespondon plotësisht me Kartën e Bolonjës sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Është organizuar me lëndë, ndarë sipas kategorive të ndryshme të veprimtarive formuese.</p> <p>Çdo lëndë i është caktuar numri i krediteve ECTS, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 1, datë 14.01.2020, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 88, Tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” korrespondon me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë specialitetesh brenda profesionit të inxhinierit elektronik dhe të komunikacionit. Grupi i lëndëve karakterizuese përbëhet nga 10 lëndë të formimit profesional, me 7.5 ECTS secila, ku 3 janë të detyrueshme dhe të përcaktuara (me emërtim dhe kod), ndërsa 7 prej tyre janë lëndë me zgjedhje dhe të papërcaktuara (pa emërtim dhe pa kod). Përgatitja e tezës ka në dispozicion 30 ECTS, ndërsa lëndët bazë dhe plotësuese kanë nga 1 lëndë me 7.5 ECTS secila.</p> <p><i>Ky lloj organizimi i kurrikulës nuk është zbatuar strikt sipas VKM.41 datë 24.01.2018, ku përveç numrit total të ECTS dhe kushtit që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”, kriteret e tjera nuk plotësohen. Nga kategoria C (lëndët ndërdisiplinore) nuk kemi asnjë lëndë. Gjithashtu vihet re se kurrikula në kategorinë B (lëndët karakterizuese) janë në 70% të pacaktuara. Kjo mund të sjellë një fare fleksibiliteti për realizimin e programit të studimit sipas kërkesave e mundësive, por gjithsesi mbetet i pacaktuar.</i></p> <p>Gjithashtu, pavarësisht elasticitetit që i jepet planit mësimor në përshtatjen e kërkesave të studentëve me mundësitë e institucionit për mësimdhënie me staf të kualifikuar, mbetet me paqartësi nëse ky program studimi përgatit specialistë “senior” dhe në cilin specialitet.</p> <p><i>Referncë: Aneks 88, Tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i</p>	<p>Fakti që mësimdhënia në Programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” zhvillohet në gjuhën</p>

<p>arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>angleze si gjuha e vetme e procesit të mësimdhënies në UE, ofron mundësinë e përdorimit të literaturës më të përditësuar dhe më të njohur në fushat përkatëse të studimit, si dhe siguron akses shumë të lehtë të studentëve në burimet elektronike dhe të shtypura të informacionit. Nga ana tjetër, duke qenë që anglishtja është gjuha zyrtare e mësimdhënies në institucion, ajo lehtëson edhe thithjen e stafit të huaj akademik, me tituj dhe grada shkencore, i mirëkualifikuar dhe me përvojë për mësimdhënie sipas kurrikulave bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Me qëllim që studentët të dalin të aftë të përfaqësojnë denjësisht veten në tregun e punës, duhet që patjetër të kenë përvetësuar programin mësimor. UE e arrin këtë duke diplomuar studentët vetëm nëse kalojnë në të gjitha lëndët dhe sigurojnë një mesatare të përgjithshme 2.00 nga 4.00, e cila me pikë i korrespondon 70-74%, ndërsa sipas sistemit shqiptar, notës 7. Kërkesa e lartë në vlerësim e gërshetuar me kurrikulën bashkëkohore zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën akademike/ profesionale. Kjo strategji është e nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” në UE përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; ë) programin lëndor (Syllabus-et); f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin. <p><i>DVV Evidencë: Aneks 54, Aneks 88</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” në UE ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite për çdo komponent: leksion, seminar, laborator,</p>

grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	punë e pavarur, detyra etj. Plani mësimor përmban 7 lëndë me zgjedhje, 4 në vitin I dhe 3 në vitin e II. Plani mësimor përmban gjithashtu 18 lëndë si alternative për lëndët me zgjedhje, duke iu mundësuar studentëve të avancojnë me studimin e profilit profesional me interes për ta. <i>DVV Evidencë: Aneks 88, tabela 10</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronikë dhe Komunikacioni” në UE ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj. Diploma disponon 30 ECTS, përbën 25% të planit mësimor , nga 10-15% që parashikon VKM.41 për këtë veprimtari formuese. Syllabusi për lëndën “Diploma” detajon aktivitetet kërkimore për zhvillimin e saj. <i>DVV Evidencë: ECE 500 course changed</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2							
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (DIK), përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” ka staf akademik të kualifikuar si në tabelën A: Tabela A						
	Viti Akademik	Prof PAE/P AK	Prof.A s PAE/P AK	Dr PAE/P AK	Msc PAE/P AK	Ndihmës Akademi	Gjithsej PAE/P AK
	2016-2017	1/1	0/1	5/4	5/7	3/0	11/13
	2017-2018	1/0	1/2	5/6	4/4	2/0	11/12
	2018-2019	1/2	3/1	3/4	6/8	0/6	13/11

2019 2020	1/1	2/1	6/6	5/3	0/2	14/11
2020 2021	0/1	1/0	6/4	8/3	6/0	15/8
2021 2022	0/0	1/4	7/3	10/7	2/0	18/14

Nga të dhënat e tabelës duket se në çdo vit akademik, DIK ka staf akademik efektiv mbi 7 PAE (11-18) me kualifikim mbi 50% me gradën shkencore “Doktor”, pra i përmbush detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.

DVV Evidencë: Aneks Nr. I. Tabelat 2.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Struktura akademike e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet nga 3 departamente:

- 1) Departamenti i Arkitekturës,
- 2) Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit,
- 3) Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike.

Ky fakultet me 3-departamentet e tij, ofron programe studime në të 3 nivelet: Bachelor, Master dhe Doktoratë. Pra Njësia kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për strukturën akademike.

Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Nga ana organizive, detyrimet ligjore e nënligjore përmbushen sepse bazuar në seksionin XI të nenit 54 të Statutit të Universitetit EPOKA, Përgjegjësi i Departamentit ka këto funksione dhe kompetenca:

- a) drejton dhe përfaqëson njësinë bazë;
- b) drejton dhe kontrollon të gjithë procesin mësimor, arsimor e shkencor të njësisë bazë;
- c) identifikon për çdo semestër dhe vit akademik, sipas kritereve ligjore, nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe ia paraqet këto nevoja dekanit dhe rektorit përkatës për të parashikuar rekrutimin e personelit akademik;
- d) Përzgjedh, në bashkëpunim me dekanin, në komisionet përkatëse të rekrutimit kandidaturat për personel me kohë të plotë dhe të pjesshme nëpërmjet një procesi të shpallur mirë dhe transparent.
- e) merr masa organizative dhe monitoruese për zhvillimin normal të procesit mësimor-kërkimor nga punonjësit e njësisë bazë që drejton;
- f) i propozon dekanit anëtarët e komisionit për mbrojtjen e tezave, provimet e formimit për programet e studimit që ai drejton;
- g) inkurajon dhe motivon punonjësit për të kryer detyrat e tyre mësimore dhe kërkimore-shkencore;

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

	<p>h) Kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve dhe kurrikulave të studimit bazuar në nevojat dhe treguesit akademikë.</p> <p>i) I propozon Dekanit përkatës nevojën e organizimit të praktikave profesionale pranë shoqërive tregtare (SHPK, SH.A.) dhe/ose institucione të tjera.</p> <p>j) I propozon dekanit kriteret e regjistrimit të studentëve, ndërsa ky i fundit i paraqet për miratim Senatit Akademik;</p> <p>k) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Universitetit ose në akte të tjera.</p> <p><i>Referencë: Raportet vjetore, Aneks 2</i></p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, përgjegjëse për Programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” përmbushin plotësisht detyrimet ligjore e nënligjore për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Numrin e personelit akademik: në çdo vit akademik ky departament ka si staf PAE një numër më të madh se 7. 2) Nivelin e kualifikimit të personelit akademik: më shumë se 50% e PAE janë me grada shkencore e tituj akademikë. 3) raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar: sipas Tabelës A, ky raport në 4 vitet e fundit akademike është në favor të PAE, ndërsa për dy vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 është pothuajse në ekuilibër, me anim të lehtë nga PAK. Duket se Universiteti EPOKA ka bërë përpjekje në përmbushje të qëndrueshme të kriterëve ligjore për personelin akademik. <p><i>DVV Evidencë: Aneks 88</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personelin akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga tabelat 2.1-2.5 kemi të dhëna për angazhimin prej DIK të personelit akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, projekteve studimore e kërkimore etj. Kryesisht janë përdorur personeli akademik ndihmës kategoria PAE, dhe vetëm në dy vite janë angazhuar kategoria PAK. Numri ndryshon sipas nevojave që DIK ka patur. Kualifikimi i tyre është sipas kriterëve ligjore: ka disa raste Nivel Bachelor, por kryesisht janë nivel Master i Shkencave.</p> <p><i>Referencë Aneks 88</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në bazë të vendimit të Bordit Administrativ të Universitetit EPOKA Nr.11, datë 02.10.2019 dhe Vendimit nr.13 të Rektoratit datë 01.10.2019, u vendos që Programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” të ketë një koordinator akademik, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>DVV Evidencë: RVB</i></p>




Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit i raporton periodikisht përgjegjësit të departamentit dhe Komitetit Shkencor i cili është përgjegjës për punësimin e stafit të ri në DIK, monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, cilësisë së kërkimit shkencor dhe dokumenton çdo informacion në lidhje me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e Programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky dokumentacion mund të merret në faqet zyrtare të MASR, ASCAL dhe publikohet në faqen kryesore të universitetit EPOKA duke përfshirë plan programin e çdo kursi. Informacioni i nevojshëm për organizimin, strukturën dhe kurrikulën e programit publikohet në faqen e departamentit. Referencë : http://cen.epoka.edu.al/
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, organizohet në lëndë, e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi për programet e ciklit të dytë. Ky program studimi nuk ka lëndë “Praktikë”. Praktika realizohet gjatë sezonit veror, për një periudhë rreth 1 javore, me një procedure që UE e ka rregulluar dhe ia bën të ditur studentit me anë të një guide me disa formularë që plotësohen prej studentit dhe supervizorit të praktikës. <i>DVV Evidencë: Praktika Profesionale</i>
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, organizohet në : a) 13 lëndë, me 120 ECTS gjithsej, ku njera prej tyre është diploma me 30 ECTS b) 7 lëndë janë me zgjedhje , dhe përzgjidhen prej studentit nga grupi me 18 lëndë me zgjedhje c) Lëndët janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian,

	<p>d) Plani mësimor realizohet sipas ndarjes në 2 vite akademike (60 ECTS secili), 4 semestra (30 ECTS secili).</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 88</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për :</p> <ol style="list-style-type: none"> ngarkesën mësimore, sipas veprimtarive mësimore : leksion, seminar, laborator, detyre kursi, projekt etj orët në auditor/ jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë gjatë një semestri Grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semester dhe çdo vit akademik. Numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë. <p>Syllabuset informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 88, Aneks 20</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, përmban informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto kritere përshkruhen në Kapitujt 6,7,8,9 të Rregullores së Universitetit EPOKA: Studimet, procesi mësimor, bursat, Provimet, transferimi i studimeve, vlerësimi, diplomimi, ekuivalentimi i studimeve etj.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 10</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë. Syllabuset janë hartuar sipas formatit të miratuar, janë në gjuhën angleze dhe japin informacion për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Për orët mësimore për: leksionet, praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Për tematikën e lëndës (leksion, seminar, laborator) në çdo javë mësimore Literaturën e rekomanduar Mënyrën e vlerësimit Detyrimet e studentit <p><i>DVV Evidencë: Aneks 20</i></p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Nga biseda me stafin akademik u konkludua se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. <i>Nga verifikimi i syllabuseve që kanë ndryshime, vihet re se:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1) <i>Për lëndën Metoda Numerike të Avancuara, ndryshimi i programit lëndor është tërësor, dhe jo në masën 20% siç parashikon ligji.</i> 2) <i>Për lëndët e tjera nuk ka ndryshime.</i> 3) <i>Në disa syllabuse nuk jepet informacion për vitin e botimit të literaturës së rekomanduar për studentët.</i> 4) <i>Literatura e rekomanduar, në rastet e pakta kur është vendosur viti i botimit, nuk është e 5 viteve të fundit.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënëit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/ “Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës për lëndët përcaktohet në plan programin e çdo lënde. Sipas kuadrit ligjor kombëtar, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe shuma mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimi për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orët e orarit të punës së studentëve, ku përfshihen orët në auditor dhe orët e pavarura të punës të përcaktuara në nenin 2 dhe nenin 79.3, Statuti i Universitetit të botuar në vitin 2016.</p> <p>Ngarkesa e punës së programit ECE është e strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e studentëve ka një ekuivalencë të matur në ECTS, dhe studentët marrin së paku 30 ECTS për semestër, dhe asnjëherë më shumë se 45 ECTS për studentët me lëndë të përsëritura.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 88, Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e kurseve dhe praktikave ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca për punësimin e studentëve. Kurset që përdorin punën laboratorike i ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë konkures në tregun e punës. <i>Por në syllabuset e lëndëve vihet re se kreditet e lëndëve ndahen në kategori: Teori/Praktikë (3/2 kryesisht). Gjithashtu nuk</i></p>

	<p><i>përcaktohen as orët për punët laboratorike dhe as tematika e tyre. E njëjta vlen edhe për kategorinë: Punë me kompjuter.</i></p> <p>GVJ sugjeron që DIK për syllabuset e këtij programi studimi të detajojë: Oret laboratorike, Tematikat e tyre. Gjithashtu duhet specifikuar çfarë nënkupton termi “Praktikë “që përcaktohet në çdo syllabus Lënde.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks Nr.20 Course Syllabus.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët, ndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi i krediteve dhe orëve mësimore mundësojnë arritjen e objektivave të formimit të programit të studimit dhe të rezultateve të pritura të të nxënit dhe formimit profesional. Studentët e programit të studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion janë vlerësuar pozitivisht nga kompanitë ku kanë kryer praktikën dhe Departamenti e ka përdorur këtë si masë të kompetencave të fituara në programin e ofruar të studimit. Gjithashtu shkalla e punësimit të tyre është shumë e lartë.</p> <p><i>DVV Evidencë: Evidencat 134-137 Raportet vjetore të UE</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit të studimit, kurset dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit të studimit Master Shkencor dhe ekuivalent me programe të ngjashme jashtë vendit. Përveç kësaj, gjuha mësimore e programit është në anglisht dhe lehtëson shkëmbimet ndërkombëtare të studentëve.</p> <p>Raporti teori / praktikë në strukturën e programit mësimor rri përafërsisht 3/2. Duke parë syllabuset e lëndëve të programit të studimit, përcaktimi i aktiviteteve mësimore pothuajse në çdo lëndë është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Teori 3ECTS 2) Praktikë 2 ECTS 3) Nuk ka punë laborator 4) Nuk ka lëndë “Praktikë” <p><i>DVV Evidencë: Annex 20, Course Syllabus,</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat e mësimdhënies në këtë program fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe me nivel të lartë të të menduarit kritik, të edukojë profesionistë që janë të aftë të adoptohen me sukses në tregun e punës.</p> <p>Aktivitetet trajnuese përmes praktikave vullnetare, praktikës profesionale, seminareve, e lehtësojnë arritjen e objektivave të mësimdhënies, transferimin e studimeve, lëvizshmërinë dhe punësimin në fund të programit të studimit të përcaktuar në kurrikul dhe të shpallur në faqen e internetit të departamenti.</p> <p>GVJ Sugjeron që :</p>




	<p>1) <i>Kurrikula të rishikohet dhe të parashikojë si lëndë të veçantë “Praktikën profesionale”, minimalisht 10 ECTS.</i></p> <p>2) <i>Gjithashtu tek syllabuset të specifikohet hapësira që i lihet Laboratoreve.</i></p> <p>3) <i>Syllabuset duhet të kenë të përcaktuara temat e detyrave të kursit</i></p> <p>4) <i>Syllabuset duhet të kenë përcaktuara temat e punëve laboratorike</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Annex 20, Course Syllabus</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo syllabus i lëndës duhet të përgatitet nga lektori i kursit dhe të futet në Sistemin Informativ në fillim të çdo semestri akademik. Fakti që anglishtja është gjuha e mësimi të programit lehtëson shumë përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve me literaturë të mirë ndërkombëtare në dispozicion. <i>Nga vështrimi i literaturës së deklaruar në syllabuse, mendojmë se duhet përditësuar, pasi për shumicën e lëndëve nuk ishte e 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Prandaj, lektori i kursit bën ndryshimet ose përditësimet e nevojshme në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex 20</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion synon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përvetësimin e njohurive dhe aftësive bazë (aftësitë teknike) dhe kompetencat e destinuar për programet e studimit të ciklit të dytë. 2) Të jetë në përputhje me Nivelin 7 të KSHK-së siç përcaktohet në ligjin nr.10247, datë 04.03.2010, “Për Kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve”, i ndryshuar. <p>Në RVB specifikohen njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që duhet të zotërojë një student i diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Elektronikë dhe Inxhinieri Komunikimi sipas Nivelit 7 në KSHK.</p> <p><i>DVV Evidencë: RVB</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimin e studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Këtë e tregon shkalla e lartë e punësimit të të diplomuarve të programeve të DIK, rreth 90%, në kompani prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.</p> <p><i>DVV Evidencë: Tabela 23, Aneks 88.</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat</p>	<p>Zyra për Planifikimin e Karrierës dhe Alumni të EPOKA-s, ruan marrëdhëniet me të diplomuarit e programit dhe marrin komentet e tyre mbi rezultatet e fituara të programit dhe mënyrën se si ato përshtaten me praktikën e tyre reale të biznesit në takimet e të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 31

<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>diplomuarve të organizuar nga Universiteti EPOKA. Kjo zyrë bashkë me Zyrën e Dekanit të Studentëve kryen një 'Anketë të Kënaqësisë së Kompanisë' që përmban disa pyetje në lidhje me kënaqësinë e studentëve gjatë punësimit të tyre dhe disa komente mbi përmirësimin e aftësive të të diplomuarve. Komentet dhe sugjerimet e marra nga punëdhënësit përfaqësojnë një kontribut të vlefshëm në procesin e rishikimit vjetor të programit të studimit. Politikës së Universitetit EPOKA</p> <p><i>DVV Evidencë: "Për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit".</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion ofron një bazë të mirë për studentët master, si përmbajtje teorike ashtu edhe shkencore, të cilët dëshirojnë të vazhdojnë studimet e tyre në një program PhD. Tabela Përmbledhëse 10 tregon planet mësimore, ku listohen lëndët, kreditet përkatëse, shpërndarja e tyre sipas aktiviteteve mësimore, përcaktimi "me zgjedhje/ e detyruar". Vihet re se janë parashikuar rreth 50% e lëndëve (7/13) si lëndë me zgjedhje.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e marrë nga dosja e vetvlerësimit, Departamenti Inxhinierisë Kompjuterike në UE synon punësimin e stafit akademik të kualifikuar në kuadër të përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi. Sipas kriterëve të parashikuara në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë", Neni 59, pika 6: Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Gjatë viteve akademike 2016-2017 deri në 2021-2022, departamenti ka angazhuar si pedagogë të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni vetëm PAE dhe PAK së paku me gradën shkencore "Doktor".</p> <p><i>Tabela 6 e Aneks 88 tregon emrat e titujve akademikë dhe emrat e lëndëve të dhëna.</i></p>

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Nga grupi i tabelave 6 dhe 7 në Aneks 88, vërehet se PAE dhe PAK, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit, sepse kanë së paku gradën shkencore Doktor, pra kanë së paku kualifikimin pasardhës në raport me programin e studimit.

Nga tabela 7 vihet re se **kryesisht angazhohet staf akademik efektiv PAE**, dhe shumë më pak staf akademik me kontratë PAK. Raporti PAE/PAK për këtë program studimi është si:

Viti akademik	Raporti PAE/PAK
2016-2017	5/2
2017-2018	4/2
2018-2019	5/2
2019-2020	6/1
2020-2021	6/2
2021-2022	7/1

Ngarkesa mësimore totale e stafit PAE që jep mësim në këtë program studimi është kryesisht sipas kuadrit ligjor në fuqi në 1 vit akademik. Tabela 4 nuk specifikon se për cilin vit akademik bëhet fjalë dhe ka të dhëna vetëm për 1 vit akademik.

DVV Evidencë: Aneks 88, tabelat përmbledhëse

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Nga shqyrtimi i jetëshkrimeve të stafit akademik angazhuar në këtë program studimi, duket se përgjithësisht fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikat e moduleve të tij. Lektorët punojnë në fusha kërkimore që mbivendosen me konceptet e mësuara në programin Master i Shkencave dhe përfshijnë elementë të kërkimit të tyre në lëndë.

Evidence: CV e stafit

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur

Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni në Universitetin EPOKA në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike ku programi ofrohet, u mundëson studentëve të programit një sërë shërbimesh që mund t'i ndihmojë ata të eksplorojnë dhe identifikojnë

<p>e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>tiparet dhe interesat e tyre personale profesionale, të mësojnë më shumë rreth opsioneve të karrierës, të fitojnë përvoja praktike</p> <p>Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, si dhe përfaqësues të biznesit dhe kompanive ofrojnë staf të mjaftueshëm, të përshtatshëm dhe të kualifikuar për mentorimin, këshillimin dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale, punimin e diplomës dhe të tjera aktivitetet specifike të programit të studimit. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, bashkëpunime që krijojnë një strukturë mbështetëse për zhvillimin e punimeve të diplomës me cilësi të lartë. Praktika profesionale nuk përfshihet si lëndë në planin mësimor.</p> <p>Departamenti DIK , sipas Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë,cakton staf të kualifikuar për Mbikëqyrja e Tezës së Masterit, ku drejtuesi i tezës zgjidhet nga stafi akademik i cili ka të paktën një diplomë doktorature</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 13</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Stafi akademik i programit angazhon asistentë dhe asistentë mësimdhënës për realizimin e seminareve dhe orëve të zgjidhjes së problemeve që ndodhen në mjediset e shkollës, për zhvillimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore. Asistentët e mësimdhënies mbështesin pedagogun gjatë kohës së mësimdhënies me aktivitete integruese dhe të bazuara në praktikë, komunikojnë materialet e kursit me studentët, marrin nënshkrimet e studentëve dhe ndjekin leksionet e klasës në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë duhet të dinë studentët, si dhe ofrojnë mësimdhënie për studentët.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 14.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="612 1308 772 1384">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="777 1308 971 1384">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="976 1308 1171 1384">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1176 1308 1377 1384">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="612 1391 772 1422"></td> <td data-bbox="777 1391 971 1422"></td> <td data-bbox="976 1391 1171 1422"></td> <td data-bbox="1176 1391 1377 1422">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Në dosjen e vlerësimit për akreditim nga ASCAL për programin e studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion, Universiteti EPOKA nuk ka depozituar një dokument që të bëjë studimin e tregut për këtë profesion. Por është e ditur se tregu ka nevojë për specialistë me kualifikim të lartë të kësaj fushe studimi. Prandaj DIK synon që të formojë me këtë program studimi specialist “senior” të inxhinierisë elektronike dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 34

<p>bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>komunikacioni. Kjo do të kërkojë përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. Nga vizita në UE u bë e qartë se personeli akademik i DIK konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës me të cilët kanë marrëveshje bashkëpunimi me qëllim përfaqshjen sa më të mirë të produktit të programit të studimit me kërkesat e tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës. Nga tabela tek Aneks 7, lista e bashkëpunimeve, rezultoi se UE ka 39 marrëveshje me institucione me qëllim edukimin dhe 42 institucione që nuk kanë qëllim edukimin. Për programin që kemi në shqyrtim MSc.ECE, nuk ka asnjë marrëveshje të dedikuar. Studentët e këtij programi studimi përfitojnë kryesisht prej marrëveshjeve për të gjithë institucionin. <i>DVV Evidencë: Annex 7</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Që studentët e programit të studimit të ndërjegjësohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rëndësinë e rezultateve të studimit, • për aktualitetin e temave mësimore dhe dobinë e tyre në formimin inxhinierik • për kërkueshmërinë dhe shpërblimin potencial të profesionit të tyre, <p>Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen në mbledhje të përbashkëta të DIK dhe dekanatit të studentëve dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. <i>Referencë: Takimet në institucion me stafin e DIK dhe studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA deklaron se ka një punësim në fushën e profesionit prej rreth 90% të të diplomuarve. Duke qenë se të diplomuarit janë më të informuar për kërkesat që ka tregu i punës për këtë profesion, institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar përmes zyrës Alumni dhe merr prej tyre propozime për plotësime, ndryshim apo përmirësimin e programit të studimit. <i>DVV Evidencë : Evidencat 134-137, Raportet vjetore Takimi me Zyrën Alumni.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Universiteti EPOKA dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë kanë një strukturë bazike të programeve të studimit, që prodhojnë specialistë me disa prej profesioneve bazë të inxhinierive (elektronik, komunikacion, kompjuterik, ndërtim) dhe arkitekturës. Kjo strukturë ka avantazhin e madh që studentët e diplomuar fitojnë një profesion të konsoliduar dhe me shkallë të lartë përshtatshmërie me programet e studimit në IAL të tjera brenda ose jashtë vendit, në rastin e vazhdimin të studimeve në nivelin tjetër. Megjithatë, në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, Universiteti EPOKA konsideron të rëndësishme</p>

	përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin me programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi. <i>DVV Evidencë: Annex 2, Statuti i UE</i> <i>Evidencat 139-149: Rishikimi i syllabuseve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Statuti i Universitetit EPOKA përcakton prioritetet dhe objektivat kryesorë të Programeve të studimit që ofron. Prioriteti më i lartë mbetet kërkimi shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. <i>Këto prioritate dhe objektiva do të shpreheshin më qartë e me detaje nëse Departamenti do të kishte rregullore të veçantë për çdo program studimi. DIK nuk ka rregullore specifike për programin e studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikuacion.</i> Veprimtaria e këtij programi studimi bazohet tek rregullorja tip që UE ka për programet e studimit të ciklit të dytë. <i>DVV Evidencë: Annex 2, Statuti i UE</i> <i>Annex 13, Rregullorja e PS të ciklit të dytë</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DIK synon rritjen e cilësisë së programeve të studimit. Si rrjedhojë me përpjekjet e saj nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, artistike, sportive që UE zhvillon. Për maksimizim të arritjeve, është e ndërgjegjshme që stafi duhet të bëjë atë për të cilën ka ekspertizë, pra duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit të tyre. Ky kujdes fillon që në momentin e rekrutimit të stafit të ri. <i>DVV Evidencë: Takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Ky program studimi ka studentë me arritje të mira akademike të ciklit të parë të studimeve. Kjo është një fillesë premtuese që programi i studimit të mundësojë, nxisë dhe motivojë studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Nga ana e tyre studentët synojnë të kenë sa më shumë eksperiencë pune në portofolet e tyre, si rrjedhim interesi është i përbashkët në pësmarrjen e tyre në projekte e kërkim shkencor. <i>DVV Evidencë: Evidencat 134-137 Raportet vjetore UE</i>
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Studentët e programit të studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikuacion synojnë përfitimin e përvojave të punësimit më të mirëpaguara relativisht për profesionin e tyre, si brenda vendit ashtu edhe në rajon ose më gjerë. Prandaj programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.

	<i>DVV Evidencë: Evidencat 134-137 Raportet vjetore UE</i>			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Veçoria e programit të studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion ka të bëjë me kërkesën e vazhdueshme për përdorimin e teknologjive bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve mësimore, studimore, kërkimore e shkencore. Prandaj njësia bazë DIK mbështetet financiarisht nga institucioni për furnizimin me pajisjet e duhura laboratorike. <i>DVV Evidencë: Evidencat 134-137 Raportet vjetore UE, Takimi me përgjegjësën e Departamentit DIK</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Universiteti EPOKA synon lidhjen e ngushtë midis programit të studimit dhe produktit për tregun e punës. Prandaj UE mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të zgjerojnë dijen, të rrisin nivelin e zbatimeve dhe të përditësojnë objektivat e kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashkëpunimit me struktura të tjera kërkimore në universitetet partnere në projektet ku është përfshirë si dhe me subjekte që kanë objektiva të ngjashme me programin e studimit në kërkimin shkencor. <i>DVV Evidencë: Anenex 7,</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DIK si njësi përgjegjëse për cilësinë e programit të studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik me ekspertizën e duhur dhe studentët më të mirë për realizimin e këtyre aktiviteteve kërkimore e shkencore. Studentët janë aktivë duke marrë pjesë në përmirësimin e programit të studimit dhe rezultateve të tij. <i>Referencë: Takimi me stafin akademik dhe studentët</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Departamenti DIK ka shumë aktivitete e projekte ndërkombëtare dhe kombëtare ku studentët dhe stafi janë aktivë të përfshirë si: <ul style="list-style-type: none"> • PanBiora (HORIZON 2020) https://www.panbiora.eu/, • projekti DIMTV Erasmus https://dimtv-project.al/ • projekti VTECH Erasmus https://cen.epoka.edu.al/home-vtech-2234-3054.html dhe • shumë projekte COST, https://cen.epoka.edu.al/. Nga takimi me stafin u pranua që Syllabusi riorganizohet nga instruktori i kursit në projekte specifike në mënyrë që të mbulojë fusha

	të ndryshme të kërkimit, edhe pse kjo nuk del e qartë nga syllabuset. Madje tek syllabuset jepen vetëm temat e leksioneve dhe nuk detajohen temat e laboratorëve, detyrave etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka udhëzime në nivel institucional për zhvillimin e metodave moderne të mësimdhënies. Plani Strategjik i Universitetit EPOKA 2018-2022 i referohet procesit mësimor si një nga tre synimet kryesore strategjike (mësimdhënie, kërkime shkencore, shërbim ndaj komunitetit) të universitetit. Ndër të tjera, në Strategjinë e institucionit ka synime si :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit duke nisur programe studimi inovative dhe multidisiplinare, 2) Përmirësimi i kurrikulës dhe 3) Përmirësimi metodologjinë e mësimdhënies. <p>Institucioni ka përcaktuar instrumentet për të matur arritjen e qëllimeve të sipërpërmendura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i kurrikulës për të integruar aftësitë e të menduarit kritik dhe sipërmarrjen, • Trajnimi i fakultetit për hartimin e kurseve sipas Sistemit të Bolonjës, • Nxiti stafin që të vlerësojë në mënyrë kritike filozofinë dhe metodologjinë e tyre të mësimdhënies • Rishikimin dhe përshtatjen e standardeve ndërkombëtare të mësimdhënies dhe menaxhimit për organet ndërkombëtare të akreditimit. <p>Për më tepër, çdo vit organizohen sesione trajnimi nën drejtimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Për shembull, gjatë vitit akademik 2019-2020 u organizua një trajnim për të gjithë stafin e institucionit nga përfaqësuesit e Shtëpisë Botuese “Pearson” në lidhje me përdorimin e teknologjisë në përgatitjen e materialeve mësimore dhe vlerësimin online. Lektorët inkurajohen nga komiteti shkencor i departamentit që të përditësojnë programet e tyre përkatëse të lëndëve në përgjigje të tendencave të tregut. Për të vazhduar me zhvillimet më të fundit teknologjike, inkurajohet përdorimi i programeve të simulimit dhe programeve të tjera profesionale.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 15</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Sipas Statutit të Universitetit EPOKA, Fakulteti dhe departamentet janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre dhe kanë objektiva të qarta për të optimizuar procesin e mësimdhënies. Në këtë kuadër Universiteti ka mbështetur stafin akademik për të rritur zhvillimin e tyre profesional dhe akademik.</p> <p>Në fund të çdo semestri, studentëve u shpërndahet një anketë nëpërmjet EIS, e cila kërkon vlerësimin e pedagogut dhe strukturën e çdo lëndë në një shkallë nga 0-4. Pasi mblidhen të gjitha të dhënat përkatëse, rezultatet</p>

	<p>i përcillen rektoratit. Përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është Përgjegjësi i Departamentit, i cili në fund të çdo semestri analizon performancën e të gjithë anëtarëve të stafit. Në rast të situatave specifike (për shembull, një rezultat i vlerësimit të studentëve më pak se 3 nga 4), Përgjegjësi i Departamentit kontakton në kohën më të shkurtër të mundshme për të përcjellë komentet tek pedagogët. Raporti i përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit i dorëzohet Fakultetit dhe më pas i përcillet Rektoratit. Përveç mekanizmit të lartpërmendur, Universiteti EPOKA ka Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë që përbëhet nga të paktën 8 anëtarë (akademikë dhe administrativë) të cilët, ndër të tjera, bëjnë vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë arsimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 17</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në fund të çdo semestri studentët kanë mundësinë të plotësojnë një anketë në lidhje me vlerësimin e secilit pedagog. Anketa është ndërtuar mbi përvojën e universiteteve të dalluara, duke përfshirë pyetje të ndryshme për të vlerësuar aspekte të ndryshme në lidhje me kursin dhe performancën e pedagogut.</p> <p>Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me zyrën e dekanit të studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të klasës ose individualisht, të cilëve mund t'i paraqesin shqetësimet e tyre në lidhje me një lëndë ose pedagog të caktuar. Nëse studentët kanë ndonjë ankesë në lidhje me notën e tyre, ata mund të kundërshtojnë rezultatin e një provimi duke plotësuar dhe dorëzuar një kërkesë për apelim notash te koordinatori i programit brenda pesë ditëve pas shpalljes së notës së provimit.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Anketa e Vlerësimit të Instrukturëve të Kursit është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies në Universitetin EPOKA. Rezultatet e përgjithshme të anketës janë pjesë e Raportit Vjetor të përgatitur për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilat bëhen publike në fund të çdo viti akademik në faqen kryesore WEB të EPOKA Universi ty. Në mënyrë periodike dhe në përputhje me kalendarin e akreditimit të Universitetit dhe të programeve të tij të studimit, përgatiten raporte të vlerësimit të brendshëm, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë dhe në në përputhje me udhëzimet e marra nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. <i>DVV Evidencë: Aneks 18</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni, kryesisht nëpërmjet anketës së vlerësimit të instruktorëve dhe rezultateve të arritura, promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të njohura. .</p> <p>Bazuar në Udhëzimin e Universitetit EPOKA "Për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë", institucioni ka miratuar "Matjen e Performancës Akademike"</p>

	<p>dhe "Formularin e Vlerësimit" që vlerëson performancën e mësimdhënies në shkallën 1-5. I pakënaqshëm < 2.5; Përmirësimi i nevojshëm < 3.0; Përmbush pritshmëritë 3.0-3.50; I tejkalon pritshmëritë 3.5-3.79; I jashtëzakonshëm. >3.8.</p> <p>Një mekanizëm formal për të siguruar përmirësim të mëtejshme të mësimdhënies është kryerja e trajnimit të stafit akademik i cili organizohet me mbështetjen e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare si dhe ka nënshkruar disa memorandume me universitete ndërkombëtare përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e lëvizshmërisë së stafit si Erasmus+ KA1 ose KA2 për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimore. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira nëpërmjet mjeteve të tij të komunikimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 19</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Universitetin EPOKA, FAI në DIK, në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni", sipas bisedës me stafin dhe studentët format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikatat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. Por në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi emërtimi i veprimtarive mësimore brenda një lënde emërtohen: Teori, praktikë, Laborator. Zbërthehet edhe koha e studimit për studentët në klasë dhe i pavarur i ndarë për provimet, detyra shtëpie etj. Nuk ka lëndë "Praktikë", ka lëndë "Projekt".</p> <p>Studentët vlerësohen në bazë të provimeve afatmesme; Provimet finale; detyra shtëpie; prezantime; projektet. Metodatat e vlerësimit janë të shprehura tek syllabuset. Secili pedagog organizon vlerësimin në përqindje të ndryshme të këtyre zërave. Syllabusi i çdo lënde miratohet nga Senati Akademik dhe nënshkruar në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i dorëzohet Rektoratit të Universitetit EPOKA përmes Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë për miratim.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneksi nr. 20</i></p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik në UE synon të respektojë dhe t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të ndryshme të studentëve, duke ofruar :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit 2) në përputhje me aktivitetet formuese , 3) në përgjigje të reagimeve të studentëve dhe 4) është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. <p>Stafi akademik monitoron rastet specifike dhe përpiqet të identifikojë sa më herët rastet kritike të studentëve që mund të rrjedhin nga aftësi të ndryshme. Në rastet kur studentët me aftësi ndryshe japin njoftim "gjysmë zyrtar" duke njoftuar Dekanin e Zyrës së Studentëve ose Përgjegjësit e Departamentit, pedagogu ofron orë shtesë për studentët. Universiteti ka staf mjekësor në kampus që ndihmon në identifikimin e gjendjeve kritike të studentëve dhe më pas ia komunikon ato stafit pedagogjik.</p> <p>Duke pasur parasysh natyrën unike të çdo kursi, kriteret e vlerësimit ndryshojnë nga një lëndë në tjetrën. Është një kombinim i mësimdhënies tradicionale (shënime leksionesh dhe prezantime gojore) dhe metodave më inovative si: miniprojekt në laborator, provimet e aplikimit, analiza kritike e punimeve kërkimore etj.</p> <p>Universiteti ofron një sërë bursash për studentët e suksesshëm master të gatshëm të ndihmojnë në kurset bachelor për një numër të caktuar orësh në javë në kurse të caktuara. Me këto bursa, departamenti tërheq studentë të mirë për programin e studimeve master shkencor, por edhe i trajnon këta studentë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Universiteti EPOKA mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnuese, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të dalluara.</p> <p>Nga ana tjetër, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron shumë metoda pedagogjike të larmishme dhe fleksibël përveç kanaleve të zakonshme të mësimdhënies si leksione dhe seminare studentët marrin pjesë në laborator, detyra dhe projekte kursi, prezantime të studentëve etj. Çdo pedagog inkurajohet të monitorojë kërkesat e tregut të punës dhe më pas kërkohet të zbatojë përditësime në mësimdhënie. Ndryshimet mund të përfshijnë riorganizimin e laboratorit dhe/ose orët e seminareve, blerje instrumentesh bashkëkohore. Në dy vitet e fundit UE ka investuar më shumë se 70.000 Euro për Laboratorin e Elektronikës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor</p>	<p>Procesi i kompetencës së mësimdhënies kurohet në këto etapa:</p>

<p>metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1) fillon nga faza e rekrutimit të PAE dhe PAK. Stafi akademik që aplikon për t'u angazhuar në mësimdhënie rekrutohet nëpërmjet një proces dinamik vlerësimi të njohurive dhe metodologjisë. 2) Formulari i Aplikimit të Stafit Akademik të Universitetit EPOKA dhe dosja me dokumentet e kërkuara që përdoren për të vlerësuar ekspertizën dhe përvojën e aplikantit, ai/ajo vlerësohet përmes një mësimi të hapur demo që teston njohuritë e tij/saj për konceptet, analizat teorike si dhe ato të përdorura metodat e mësimdhënies. 3) Verifikohet nëse Stafi akademik është i specializuar në nëndisiplinën specifike në të cilën ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë kompetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme mësimore sipas temave dhe profileve. 4) Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënës Komisioni i Përhershëm për Cilësi dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon seminare të ndryshme. <p>Për të mundur një metodologji mësimore më efektive të bazuar në TIK, kompjuterët e klasës dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjithë softuerin, programet dhe paketat e nevojshme që nevojiten në kurse të veçanta të këtij programi studimi.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 21, Aneks 22, Aneks 23, Aneks 24</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>DIK vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies nëpërmjet zbatimit të Anketës për Vlerësimin e Instrukturëve të Kursit, si një nga mjetet kryesore që përdoret për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Anketa zhvillohet në baza semestrale, aktivizohet në sistem një muaj para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet përpara përfundimit të notave përfundimtare të kursit në sistem. Rezultatet e anketës përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësimet e mëtejshme. <i>DVV Evidencë: Aneks 24,</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master I shkencave në Inxhinierisë Elektronike dhe Komunikimit ofron metoda pedagogjike të larmishme dhe fleksibël përveç formave të zakonshme të mësimdhënies si leksione dhe seminare. Studentët marrin pjesë në punë laboratorike, detyra dhe projekte lëndësh, mbajnë prezantime studentore etj. Diversiteti i metodologjisë së mësimdhënies është ndërveprues. Gjatë ligjëratave dhe seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve organizohen në formë diskutimi duke i bërë orët më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p>Gjatë situatës pandemike, kurset e këtij programi studimi u ofruan online duke përdorur infrastrukturën HYFLEX të disponueshme në çdo klasë dhe laboratorë elektronike. Gjatë vitit akademik 2021-2022 të gjitha klasat ofrohen në kampus bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është pjesëmarrës</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 43

	<p>i një Projekti Evropian që fokusohet në zbatimin e realitetit virtual në klasa. Ky projekt i titulluar "Përshpejtimi i modernizimit të Universitetit të Ballkanit Perëndimor duke inkorporuar teknologjitë virtuale (Vtech@WBUi)" ka partnerë nga gjashtë vende të ndryshme evropiane.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 51, Aneks 52</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Metodat e mësimdhënies si prezantimet e studentëve, projektet, detyrat e shtëpisë dhe puna në grup, nxisin ndjenjën e autonomisë, punës ekipore dhe të të menduarit kritik tek studentët. Në të njëjtën kohë ofrojnë mbikëqyrje dhe mbështetje nga pedagogu, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues ku studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre.</p> <p>Lektorët mbajnë një komunikim të mirë me studentët duke mundur një marrëdhënie reciproke respektuese.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi mësimor dhe shkencor në UE Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive, zhvillohet në ambiente të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe të mirëmbajtura. Institucioni ka kampusin e tij të ri - i përfunduar në 2011 - me pajisje moderne. Administrata ka punësuar një kompani pastrimi që është gjithmonë e pranishme në kampus. Një ekip teknikësh të punësuar me kohë të plotë mirëmban të gjitha ambientet duke përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambienteve të brendshme në dimër, klimatizimin gjatë verës dhe mirëmbajtjen e ambienteve sportive. <i>DVV Evidencë: Aneksi 30.</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Klasat dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë, sisteme zanore, lidhje wireless, tabela inteligjente, instrumente eksperimentale, wireless në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekë modem etj. Për të mundur një metodologji më efektive të mësimdhënies, laboratorët e kompjuterave dhe laboratorët elektronikë përmbajnë të gjithë harduerin dhe softuerin, programet dhe paketat e nevojshme që nevojiten në lëndë të veçanta të këtij programi studimi. Ambientet e dedikuara për programin Mdc në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni përfshijnë tre laboratorë kompjuterash dhe tre laboratorë elektronikë. Dy nga laboratorët e elektronikës përdoren për klasa, dhe një laborator përdoret për projektet e studentëve, i mjaftueshëm për t'iu përshtatur të gjithë studentëve dhe janë plotësisht të pajisur me logjistikën e nevojshme. <i>DVV Evidencë: Aneksi 31.</i></p>

<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përdorin sisteme të ndryshme të IT-së dhe infrastrukturën e konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin mësimor. 2) Duke filluar nga regjistrimi i tyre, studentët pajisen me një adresë emaili e cila u ofron studentëve dhe stafit mundësi të mëdha përmes veçorive të postës elektronike epoka.edu.al të bazuara në google, si memorie dhe share pa kufi në google drive, google classroom etj. 3) Me anë të kësaj adrese emaili, studentët kanë akses në llogarinë e tyre personale të Sistemit Interaktiv EPOKA EIS nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me Universitetin. 4) Përmes sistemit të menaxhimit të Leaming LMS çdo pedagog mund të hapë një llogari kursi nga e cila lektorët ndajnë shënimet e leksionit, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e shtëpisë dhe aktivitete të tjera të ngjashme të nevojshme për kursin specifik. 5) Kampusi ka akses wireless në të gjitha ndërtesat dhe tre laboratorët kompjuterikë janë të pajisur me programet e nevojshme softuerike. <i>DVV Evidencë: 30</i>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ofron një numër të konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit EPOKA. Është literaturë bashkëkohore dhe pasqyrohet në planprogramet e lëndëve. Në bazë të kërkesave të stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Studentët gjithashtu kanë akses në një soft-kopje të materialit që ofrohet nga stafi akademik në platformën e aksesueshme online.</p> <p>Biblioteka ka një fond të pasur librash për secilën nga disiplinat e studimit të ofruara nga Universiteti. Ato konsiderohen të mjaftueshme për realizimin me sukses të Masterit të Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi, megjithatë përditësohen vazhdimisht. Librat e bibliotekës janë të inventarizuar dhe të ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: shqip, anglisht, turqisht etj. Koleksioni i bibliotekës pasurohet me blerje dhe donacione nga persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë. Librat e blera përzgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Shih aneksin nr. 32.</p> <p>Universiteti EPOKA ofron literaturë multidisiplinare në bibliotekën e tij. Biblioteka ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra ose revista shkencore që nevojiten për përfundimin me sukses të programit të studimit, projekteve kërkimore dhe përgatitjes së tezës më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga shtypja në operacione dixhitale, për të zgjeruar aksesin në</p>

	<p>përmbajtjen shkencore në mbarë botën dhe për ta ruajtur atë për brezat e ardhshëm.</p> <p>Çdo anëtar i stafit të EPOKA-s mund të aksesojë koleksionet e JSTOR duke shkruar në http://www.jstor.org/ dhe duke kërkuar ose shfletuar për përmbajtje. Menaxherët e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, duke përfshirë buxhetin e planifikuar për të. <i>DVV Evidencë: Aneks 33</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka ndodhet në katin e parë të ndërtesës A dhe është themeluar për të mbështetur aktivitetet arsimore dhe kërkimore të universitetit duke siguruar dhe organizuar dokumentet e nevojshme.</p> <p>Me kapacitetin e saj prej 100 vendesh, biblioteka ka një sipërfaqe përdorimi prej 400 m². Ajo përmban hyrjen; zyra administrative, qendra kërkimore, salla e librave dhe leximit. Në hyrje ka një tavolinë check out. Salla e leximit është e pajisur për studentët për të studiuar dhe për të kryer kërkime.</p> <p>Universiteti EPOKA është anëtar i Unionit të Bibliotekave Ballkanike prej 2009 me pjesëmarrjen e institucioneve nga 6 vende të Ballkanit.</p> <p>Koleksioni i bibliotekës pasurohet me blerje dhe donacione. Blerjet e librave të rinj bëhen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik. Në kuadër të Departamentit të Bibliotekës dhe Dokumentacionit, biblioteka ka gjithsej rreth 25000 libra të shtypur. <i>Evidencë: Aneks 30</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka akses në bibliotekat online ku studentët mund të lexojnë dhe shkarkojnë libra dhe punime të shumta shkencore. Aktualisht, Universiteti EPOKA ka akses në JSTOR, një bibliotekë dixhitale e përbashkët e krijuar në vitin 1995 që përfshin më shumë se 2000 revista akademike dhe shkencore. Në të njëjtën kohë është i abonuar në bazën elektronike të të dhënave ERA të menaxhuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe disa burime të tjera online si: Bio One, Cambridge Journals Online, ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Management e-Journal Collection, IOP Science, Multi-Science Journals Collection, OECD eLibrary, Oxford English Dictionary Online, Oxford Reference Online, ProQuest Central, Taylor & Francis Library, Web of Knowledge.</p> <p>Çdo anëtar i stafit dhe studentë të EPOKA-s mund të hyjë në këto baza të dhënash dhe të kërkojë artikujt ose revistat e kërkuara. Ata mund të kenë akses në çdo artikull të vetëm duke e bërë më të lehtë për ta kryerjen e kërkimit të tyre shkencor në fushat përkatëse të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike,</p>	<p>Studentët e EPOKA-s kanë akses të pakufizuar në: dy rrjete wireless të disponueshme në të gjithë kampusin; Office 365 dhe DreamSpark. Përveç kësaj, ka tre laboratorë kompjuterikë, dy laboratorë të elektronikës dhe një dhomë studimi doktorature dhe një bibliotekë ku PC-të u shërbejnë studentëve dhe anëtarëve të stafit me internet me</p>

shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	kablo. Kurset kanë 3 orë teori dhe dy orë praktikë (seanca laboratorike ne syllabus shënon 0) në javë. Në këtë mënyrë, studentët marrin përvojë praktike në zgjidhjen e problemeve të botës reale dhe vënien në përdorim të teorisë. <i>DVV Evidencë: Aneks 30</i>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Universiteti EPOKA përdor shërbimet elektronike të mëposhtme të lidhura me mësimdhënien:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Turnitin - Softuer që ndihmon përdoruesit të kuptojnë dhe shmangin plagjiaturën dhe të zhvillojnë të kuptuarit e tyre se si të citojnë burimet si pjesë e një argumenti akademik. Zyra e ICTC menaxhon përdoruesit dhe trajnon stafin se si të përdorin Turnitin. 2) Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS) - Një shërbim i bazuar në Moodle i ofruar për studentët dhe instruktorët në mënyrë që të kenë akses, koordinim dhe organizim të materialeve të kursit në internet. Studentët dhe instruktorët mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit të dhënë. 3) Sistemi i Automatizimit të Bibliotekave (Koha) - Koha është një sistem i integruar i bibliotekave me burim të hapur që përdoret sot nga qindra biblioteka në mbarë botën. Koha është i bazuar në ueb, kështu që nuk ka softuer për t'u instaluar në kompjuterët desktop. Përdoruesit mund t'i kontrollojnë librat në internet dhe t'i rezervojnë ato nëpërmjet internetit. Karakteristikat e tij janë më se të mjaftueshme për të menaxhuar në mënyrë efektive dhe efikase Bibliotekën EPOKA. 4) Google Classroom - Një shërbim interaktiv i ofruar nga Google për të aksesuar, koordinuar dhe organizuar materialet e kursit në renë kompjuterike. Duke përdorur Google Classroom, materialet e kursit mund të integrohen me shërbime të tjera të Google ku përdoruesit e caktuar mund të bashkëpunojnë. Studentët dhe instruktorët mund të hyjnë në këtë shërbim duke përdorur llogarinë e dhënë. 5) Webmail (Llogaria Google) - Universiteti EPOKA përdor shërbimet e Google Apps for Education dhe të gjithë studentët dhe stafi akademik dhe administrativ pajisen me një adresë emaili nën domenin epoka.edu.al që është një llogari Google. Krahas komunikimit zyrtar, i cili bëhet përmes kësaj adrese emaili, kjo llogari mund të përdoret për autentifikimin në sisteme të tjera online të ofruara nga universitetet. <p>Të gjitha shërbimet elektronike të lartpërmendura përdoren në baza ditore nga studentët dhe stafi akademik pasi ato janë kanalet kryesore në të cilat aksesohet materiali i kursit dhe komunikimi formal bëhet në Universitetin EPOKA. <i>DVV Evidencë: Aneks 30</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e</p>	<p>Stafi akademik përdor Sistemin (EIS) për të regjistruar dhe mbajtur gjurmët e frekuentimit të studentëve, për të publikuar detyrat dhe notat</p>

komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.

e provimeve dhe për të monitoruar performancën e studentëve. EIS është një produkt i zhvilluar nga zyra e IT-së e Universitetit EPOKA. Këshilltarët akademikë të studentëve e përdorin atë për të monitoruar performancën e secilit student në të gjithë programin e studimit.

EIS është një sistem interaktiv online ku përdoruesit mund të identifikohen duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit të dhënë. Është një sistem modular i organizuar nga rolet dhe njësitë përkatëse në universitet që ruan informacionin në një bazë të dhënash të centralizuar. Të gjithë përdoruesit mund të: aksesojnë informacionin e tyre personal, të përditësojnë detajet e përgjithshme dhe CV-në dhe mund të menaxhojnë detyrat dhe aktivitetet e lidhura me punën sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës.

Studentët në profilin e tyre mund të kenë akses në të dhënat dhe informacionet e tyre personale në lidhje me programin e tyre të studimit. Regjistrimi i lëndëve bëhet përmes sistemit dhe më pas studentët mund të shikojnë aktivitetin e vazhdueshëm akademik të lëndëve të regjistruara gjatë semestrit. Ata mund të kontrollojnë pjesëmarrjen, datat e provimeve, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu, në sistem, ata mund të aksesojnë kurrikulën e programit, transkriptin, llogaritjen e notave, orarin javor, kërkesat dhe njoftimet. EIS i nxit studentët kur janë në "zonën e paralajmërimit" për çështje financiare ose akademike.

Stafi akademik ka akses në informacione për kurset aktuale dhe ato të caktuara më parë. Ligjëruesit mund të përditësojnë planprogramin, të plotësojnë pjesëmarrjen e studentëve, të caktojnë dhe të finalizojnë notat. Nga ana tjetër, këshilltarët akademikë kanë akses në informacionet akademike të studentëve të caktuar për këshillim dhe

Koordinatorët mund të monitorojnë veprimtarinë akademike të pedagogëve të departamentit përkatës nëpërmjet EIS.

Pranimet dhe Zyra e Regjistrimit: Zyra e Pranimeve fut të gjitha informacionet e studentëve të regjistruar paraprakisht dhe cakton bursa. Pasi studenti të ketë përfunduar regjistrimin, të gjitha informacionet përkatëse të futura nga zyra e pranimeve, menaxhohen nga zyra e gjendjes civile.

Financa: Zyra e Financës menaxhon dhe ndjek të gjitha informacionet financiare të studentëve në lidhje me tarifën e shkollimit dhe bursën.

Burimet Njerëzore: Zyra e Burimeve Njerëzore menaxhon të dhënat e stafit dhe cakton rolet dhe pozicionet e punës për çdo anëtar të stafit.

Kurrikula: Një faqe interneti që përmban informacione në lidhje me programet e studimit, kurrikulën dhe planprogramin e lëndëve.

Të gjithë përdoruesit kanë akses në raportet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësitë përkatëse. Fakultetet dhe njësitë janë të çliuruara nga detyrat e lodhshme manuale. EIS i furnizon ata me informacionin

	<p>më të përditësuar që do t'i fuqizojë ata të marrin vendime të bazuara në të dhëna.</p> <p>EIS mund të përditësohet vazhdimisht me module të reja sipas nevojave të universitetit. Gjithashtu, stafi dhe studentët mund të identifikohen në EIS duke përdorur kredencialet e llogarisë së tyre EPOKA Mail.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 30, Aneks 34, Aneks 35.</i></p>								
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në semestrin e katërt, studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion marrin vetëm tezën e Masterit. Ky program studimi menaxhon mbikëqyrjen e tezës me ndihmën e stafit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Stafi akademik i Inxhinierisë Elektronike dhe Komunikimit përdor disa qasje për mbikëqyrjen e projekteve të diplomimit. Çdo mbikëqyrës organizon takime grupore dhe individuale me studentët, takime të cilat kryesisht janë të përfshira në planprogramin e projektit të diplomimit.</p> <p>Për të pasur një cilësi të mirë të tezës, studentët marrin Team Project gjatë semestrit të tretë të programit master të shkencës. Në projektin team studentët fillojnë të punojnë në projektin e tezës së tyre. Ata përcaktojnë temën e tezës me udhëheqësin gjatë semestrit të tretë.</p> <p>Organizohen dy raunde prezantimi, njëri në fillim të semestrit dhe tjetri para dorëzimit të projektit të diplomimit. Këto prezantime organizohen nga mbikëqyrësi dhe gjithashtu ftohen nga mbikëqyrësi, personeli tjetër mësimdhënës i programit ose departamente të tjera brenda fakultetit, për t'u ofruar studentëve reagime specifike në mënyrë që të përmirësojnë kërkimin e tyre. Gjatë prezantimit të parë studentët japin një propozim dhe marrin komente për temat e përzgjedhura, ndërsa gjatë prezantimit të dytë studentët ofrojnë një përmbledhje të rishikimit të literaturës dhe metodologjisë së studimit të tyre si dhe rezultate nga analiza e tyre. Në fund të semestrit, mbikëqyrësi vlerëson çdo projekt diplomimi bazuar në performancën e prezantimeve të studentëve përkatës dhe takimet e tyre periodike dhe punën e tyre përfundimtare të paraqitur duke iu referuar kontributit të secilit prej tyre në klasën përfundimtare siç specifikohet në planprogram.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional	Senati Akademik i Universitetit EPOKA ka krijuar Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të

<p>që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Lartë. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë me nën-njësitë e tij si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, • Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, • Bordi i Provimeve dhe Vlerësimi i Performancës Akademike • Bordi i Përmirësimit të Cilësisë <p>Përbën Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Universitetit EPOKA me strukturë dhe funksion të përcaktuara në Statutin e Universitetit EPOKA dhe Rregulloren përkatëse të funksionimit dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë Universitare EPOKA. Gjithashtu, sipas Statutit të Universitetit EPOKA Neni 35 dhe 37, universiteti ushtron Politikën e Cilësisë e cila mbulon politikat në lidhje me parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë.</p> <p>http://aegi.epoka.edu.al/cat-qualitysiguri-dokumentet-J4_04.html</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneksi 36, Aneksi 37.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti, si njësia bazë, është përgjegjëse për mirëfunksionimin e programeve përkatëse të studimit si dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë së tyre. Siç thuhet në nenin 12 të "Statutit të Universitetit EPOKA"</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit të stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Ky është një proces i plotë që nis nga punësimi i pedagogëve cilësorë përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e Universitetit EPOKA. Duke qenë se gjuha e mësimin është në anglisht dhe duke pasur parasysh se fusha e studimit kërkon përditësime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë që përdorin domenet ndërkombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex nr.2 - Statuti i Universitetit EPOKA - http://epoka.edu.al/mat/legal_acts/Statute_Uni_EPOKA_en.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas bisedës me personelin akademik, Universiteti EPOKA është në kërkim të ideve të reja, që i japin vlerë programit të studimit. Në përputhje me këtë, EPOKA është e përkushtuar të punësojë staf akademik nga vende, prejardhje dhe kultura të ndryshme, duke pasuruar kështu programet me metoda të reja të mësimdhënies. Departamentet mirëpresin çdo sugjerim që mund të sjellin lektorët në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies dhe sigurohen që të ofrojnë mbështetje maksimale për stimuj dhe qasje të tilla. <i>Referencë: Takimi në UE me NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon seminare dhe trajnime të ndryshme në kuadër të përmirësimit të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore, aktivitete të mbajtura nga trajnerë ndërkombëtarë.</p>

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>DVV Evidencë: Aneks 25 dhe http://aegi.epoka.edu.al/cat-training-activities-J411.html</i>		
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Stafi akademik dhe mbështetës është i përfshirë në trajnime dhe projekte shkencore ndërkombëtare, që i ndihmojnë ata në përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave të lëndëve mësimore në aspektin e përmbajtjes dhe metodologjisë së mësimdhënies. Personeli akademik, paralelisht me përgjegjësitë e tij mësimore, është i angazhuar edhe në kërkim shkencor. Gjithashtu, Universiteti mbështet publikimet shkencore të pedagogëve të tij dhe inkurajon kryerjen e kërkimeve të përbashkëta. <i>Referencë: Takimi me stafin akademik në UE.</i>		
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin caktimin e ligjëruesit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që kurset specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulën e plotë. <i>Referencë: Takimi me stafin akademik në UE.</i> <i>DVV :Annex 12, Staf CV</i>		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik (përfshirë asistent lektorë, asistentë mësimdhënës) testojnë metoda të reja të mësimdhënies, analizojnë efektet dhe raportojnë në departament për gjetjet. Procesi i mësimdhënies është i lidhur me nivelin e studentëve të ardhur nga shkollat e mesme dhe ndryshimet në kurrikulat e tyre parauniversitare ndikojnë në cilësinë e studentëve të ardhur. Në këtë rast DIK monitoron performancën e tyre akademike duke filluar nga viti i parë dhe në bazë të vlerësimit zbatojnë përfshirjen e mentorëve për studentët në vitin e parë. <i>Referencë: Takimi me stafin akademik në UE.</i>		
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Institucioni, në bazë të propozimeve të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, lejon leksione të hapura ose prezantime nga pedagogë nga universitete të tjera në Shqipëri ose jashtë saj. Kur lektorë nga universitete të tjera ftohen t'u prezantojnë studentëve të Masterit të Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni, ata paraqesin qasjen e tyre si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim; duke përfshirë perspektivën arsimore nga Evropa kontinentale, sistemi britanik dhe sistemi amerikan. Pedagogët e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike prezantojnë gjatë leksioneve të tyre punën kërkimore që i ndihmon studentët të kuptojnë se si informacioni i tyre themelor i mësuar mund të zbatohet në kërkime ose në tregun e punës. <i>Referencë: Takimi me stafin akademik në UE. DVV Referencë: Evidencat 134-137, Raportet vjetore UE</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




Standardi III.5**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka rregullore transparente dhe të aksesueshme nga studentët, për të gjitha aspektet në zhvillimin e lëndëve dhe vlerësimin e provimeve të studentëve. Nenet 20-23 të rregullores "Rregullorja për ciklin e dytë të programit të studimeve" japin :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacion të detajuar në lidhje me çdo çështje që lidhet me provimet • Informacion të përgjithshëm për çështje me interes për studentët Master që nga fillimi i studimeve deri në diplomim. <p>Universiteti zhvillon sesione orientuese për të informuar studentët për të gjitha proceset, politikat dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Siç thuhet në seksionin e vlerësimit me notë të Udhëzuesit Smart Student, "Nota përfundimtare e një kursi përfshin vlerësimin e të gjithë komponentëve të kursit (provimet e mesme, kuize, studime në terren, praktika, detyra, projekte, seminare, frekuentim, punë laboratorike, etj.) Brenda një semestri në lidhje me këtë lëndë dhe rezultatin e provimit përfundimtar sipas sistemit të vlerësimit të performancës së lëndës.</p> <p><i>DVV Evidencë: https://epoka.edu.al/mat/Student_Guide_2021-2022-inal.pdf.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të çdo semestri, studentët prezantohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Anëtarët e Stafit Akademik i paraqesin të gjitha elementet e lartpërmendura dhe ngarkon programin mësimor përkatës në EIS. Programi mësimor për çdo lëndë mund të aksesohet nga studentët gjatë gjithë vitit akademik online.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex Nr.34, Guida e studentit</i></p> <p><i>Annexs: 40,43,44</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Metoda e testimit dhe vlerësimit të kompetencave profesionale dhe aftësive kërkimore realizohet në modele dhe mënyra të ndryshme, duke u dhënë studentëve mundësinë për të demonstruar kompetencat dhe njohuritë e fituara. Metodatat e vlerësimit zgjidhen në varësi të natyrës së kursit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex Nr.35, Guida e lektorit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>




Standardi III.6**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale synon të bëhet gjatë gjithë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar gjatë gjithë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve gjatë gjithë semestrit. Në përgjithësi, ka dy afate kohore të dedikuara për provimet afatmesme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare (java 15 dhe 16-dy javët e fundit të semestrit). Midis provimeve studentëve u kërkohet të punojnë në projekte ose të bëjnë një prezantim, sipas çdo kursi, ose detyrat përkatëse siç janë përcaktuar në planprogramin e çdo lënde të ofruar në kurrikulat e programit të studimit. <i>DVV Evidencë: Aneks 20</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminonin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UE përdor disa forma dhe mediash vlerësimi, duke përfshirë elektronike, të bazuara në letër dhe të bazuara në performancë, për testimin dhe vlerësimin e studentëve, për të ofruar një kuptim të plotë të aftësive të studentëve. Përdoren disa strategji vlerësimi, si: kuize, provime, projekte, punime, prezantime, diskutime në klasë, raste studimore dhe të tjera. Universiteti EPOKA përdor sistemin elektronik EIS për të anonimizuar provimet afatmesme dhe ato finale, në mënyrë që edhe provimet e bazuara në letër të jenë anonime. Në fletët e provimit studentët mund të shkruajnë vetëm ID-në e Provimit dhe jo emrat, mbiemrat e tyre (Vendim i Rektoratit datë 11.05.2019 "Për sigurimin e anonimitetit të provimeve me shkrim të afatmesme, përfundimtare, përsëritëse dhe plotësuese të kryera në nr. të gjitha ciklet e studimeve në Universitetin EPOKA që nga semestri i vjeshtës 2019-2020"). Të gjitha notat futen në mënyrë elektronike në Sistemin Interaktiv EPOKA (EIS). Nëpërmjet këtij sistemi, studentët mund të kenë akses në profilin e tyre, kurset, notat, frekuentimin, transkriptin dhe përzgjedhjen e lëndëve. Gjithashtu, Tumin, një shërbim online, përdoret gjithashtu për të kontrolluar dokumentet e studentëve dhe tezat e diplomimit për ngjashmëri dhe për të siguruar që studentët të ndjekin praktikant transparente të referimit dhe dokumentacionit. Nga ana tjetër, një përzgjedhje e provimeve i nënshtrohet kontrollit të cilësisë nga Ekspertët e Provimit. Provimet arkivohen nga Universiteti. Universiteti ka sistem për të trajtuar pretendimet për praktikë joetike si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik dhe ofron procedura me të cilat studentët mund të kontestojnë notat e provimeve. Qasjet e ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë përdorimin e mjeteve elektronike, parashikojnë një proces vlerësimi transparent në Universitetin EPOKA.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 40, Aneks 42, Rregullorja e studentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga</p>	<p>Testimet përfundimtare të studentëve në programin e studimit Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacionit konceptohen, vlerësohen dhe miratohen nga të paktën dy anëtarë jurie. Përgjegjësi i Departamenti nënshkruan tezen përfundimtare. Provimet mbikëqyren nga staf shtesë sipas nevojës, bazuar në numrin e studentëve, për të parandaluar praktikant joetike nga studentët gjatë provimeve. Një përzgjedhje e</p>




<p>njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>provimeve i nënshtrohet kontrollit të cilësisë nga Ekspertët e Provimit. Provimet arkivohen nga Universiteti. Universiteti ka sisteme të vendosura për të trajtuar pretendimet për praktikë joetike si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik dhe ofron procedura me të cilat studentët mund të kontestojnë notat e provimeve. Për provimet me gojë kërkohet të jenë të pranishëm dy vlerësues. <i>DVV Evidencë: Aneks 44, Aneks 45</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>UE ka infrastrukturë të dedikuar për të siguruar anonimitetin e fletëve të provimit. Studentët marrin një kod të personalizuar për çdo periudhë provimi, të cilin e dinë vetëm ata dhe koordinatori i departamentit. Kodet janë të inkorporuara edhe në sistemin EIS ku pedagogu vendos notën që i përket kodit përkatës. Pedagogu mund të shohë emrat e studentëve vetëm pasi të përfundojë notat e lëndës. Universiteti EPOKA ofron gjithashtu hapësirë të dedikuar për klasa dhe vëzhgues për të siguruar që provimet të zhvillohen pa shkelje etike. Kamerat e sigurisë janë të vendosura në vende strategjike në të gjithë Universitetin dhe në klasa për të ofruar një shtesë të përgjegjshmërisë dhe transparencës. <i>DVV Evidencë: Aneks 46</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogët përdorin në mënyrë rutinore komente, vlerësime formuese dhe përmbledhëse që u ofrojnë studentëve reagime shtesë për të nxënit dhe ato që kryesisht përcaktojnë performancën përfundimtare të një studenti në një lëndë. Atyre u kërkohet të dorëzojnë çelësat e përgjigjeve në Departament së bashku me provimet e mesme dhe përfundimtare dhe fletët e notave. Pedagogët u japin kohë studentëve që të shohin provimet pasi të jenë vlerësuar me notë.</p> <p>Procedura për përfundimin e një teze diplome/diplomimi përfshin vlerësimin formues pasi studentët konsultohen me këshilltarin e tezës për të shkruar tezën dhe gjithashtu marrin reagime nga juria e tezës për ndryshimet e nevojshme përpara dorëzimit përfundimtar të tezës. Kështu, u ofrohen mënyra të shumta reagimi që studentët të mësojnë nga puna e tyre për t'u përmirësuar në të ardhmen. <i>DVV Evidencë: Vizita në UE</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti EPOKA, njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra me procedura dhe instrumente për të luftuar plagjiaturën dhe mashtrimin. Tunitin, një shërbim online, përdoret për të kontrolluar dokumentet e studentëve dhe tezat e diplomimit për ngjashmëri dhe për të siguruar që studentët të ndjekin praktikat transparente të referimit dhe dokumentacionit. Universiteti ka sisteme të vendosura për të trajtuar pretendimet për praktikë joetike si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik dhe ofron hapësira, mbikëqyrje dhe CCTV për të parandaluar mashtrimin në provime.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 42, Aneks 46, Aneks 47</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimet në Universitetin EPOKA janë të bazuara në merita dhe rezultatet ndahen me studentët në afat, janë të përcaktuara në planprogramin e çdo kursi, së bashku me objektivat e kursit, rezultatet e të nxënit dhe metodat. Tre instrumente sigurojnë që vlerësimet të jenë të bazuara në merita.</p>

	<p>1) Provimet i nënshtrohen rishikimit nga Ekspertët e Provimit për të kontrolluar nëse ata vlerësojnë konceptet e mbuluara në planprogram (Shih Direktivën e Universitetit EPOKA për Funksionimin e Bordit të Provimeve 21.11.2018). Provimet arkivohen nga Universiteti.</p> <p>2) Studentët japin komente mbi kurset dhe performancën e instruktorëve përmes një ankete anonime mbi EIS. Ky sondazh përfshin pyetjen "Instruktori e vlerësoi punën time në mënyrë të drejtë".</p> <p>3) Universiteti siguron vlerësimin e bazuar në merita duke ofruar procedura me të cilat studentët mund të kontestojnë notat e provimeve (Udhëzuesi Smart Studentor EPOKA 2021-2022 70).</p> <p>Kalendari Akademik përcakton qartë afatet për të siguruar komunikimin në kohë të rezultateve të vlerësimit me studentët.</p>								
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA ofron online procedurat e vlerësimit përmes faqes së tij të internetit, për sa i përket rregulloreve që drejtojnë procedurat e vlerësimit, Guidës së zgjuar të studentëve 2021 -2022, si dhe në detaje të llojeve të vlerësimeve dhe peshës së notave të vlerësimeve në planprogramet e kurrikulës. Studentëve u jepen më tej udhëzime mbi procedurat e vlerësimit në sesionet orientuese dhe nga pedagogët. Studentëve u garantohej e drejta për të kërkuar rishikimin e provimeve të tyre. Regjistrat e rishikimeve të notave të provimeve mbahen në Dekanatin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.</p> <p><i>DVV Evidencë: Aneks 45, Aneks 47, Aneks 48.</i></p>								
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Studentët kanë disa mënyra për të adresuar ankesat në lidhje me vlerësimin me notë ose elementë të tjerë të mësimin. Ankesat në vlerësimin me notë mund t'i drejtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një profesor ose pedagogu, i cili mund të paraqesë një kërkesë për ndryshim note nëse ai/ajo konstaton se nota ishte e pasaktë. • Ankesat mund t'i drejtohen edhe Dekanit të Studentëve, i cili mund ta dërgojë ankesën në Fakultet për shqyrtim. <p>Pastaj Fakulteti mund të caktojë një ekip ad-hoc për të hetuar ankesën dhe për t'i raportuar Fakultetit. Procedura e ndjekur dokumentohet nga Fakulteti.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1512 762 1579">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="762 1512 970 1579">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="970 1512 1177 1579">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1177 1512 1428 1579">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1579 762 1650"></td> <td data-bbox="762 1579 970 1650"></td> <td data-bbox="970 1579 1177 1650"></td> <td data-bbox="1177 1579 1428 1650">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të	Kurrikula duhet të ofrojë mundësi mësimi për studentët që të fitojnë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme e të veçanta për suksesin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 55




<p>garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>profesional. Lëndët që kanë elemente praktike si objektiva të lëndës, kanë orë praktike që vlerësojnë në mënyrë sasiore kompetencat teknike të studentëve. <i>Por nga vëzhgimi i syllabuseve të këtij programi studimi del se nuk parashikohen orë laborator, ky tregues plotësohet me "0" në syllabus.</i> Gjithshka që ka lidhje me formimin e kompetencave e shprehive praktike përmbledhet në termin "Praktikë", ku bëjnë pjesë edhe zhvillimi i seminareve. Zhvillimi i aftësive të veçanta, apo aftësive harduerike për studentët e Msc. Inxhinierisë Elektronike dhe Komunikacioni mundësohet duke i angazhuar ata në punën kërkimore të stafit të departamentit. <i>DVV Evidencë: Aneksi 20</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë gjuhën e huaj). Shumica e këtyre aftësive ofrohen në kursin Metodatat e Kërkimit, ku studentët mësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • se si të komunikojnë në mënyrë efektive, • si të merren me kritikën kur prezantojnë punën e tyre në konferenca • si të bëjnë saktë pyetje në takime. • si të ndërveprojnë në mënyrë etike kur komunikojnë dhe kur raportojnë punën me shkrim <i>DVV Evidencë: Aneksi 20</i>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Syllabuset e çdo lënde përshkruajnë kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, dhe analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Kujdes bëhet që të kontrollohet dhe cilësia e niveli i provimit në përputhje me objektivat e programit të studimit. Në nivel institucional, kjo rregullohet nëpërmjet Direktivës "Për Funkcionimin e Bordit të Provimeve" në bazë të së cilës çdo fakultet cakton një ekspert për çdo program studimi për të vlerësuar cilësinë e provimeve, ku verifikohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) nëse provimi është hartuar në përputhje me objektivat e kursit 2) nëse pasqyron materialet e ofruara gjatë leksioneve. <p>Gjithashtu Bordi i Provimeve bën analiza të të gjitha rezultateve të provimeve. <i>DVV Evidencë: Aneksi 41, Formulari i vlerësimit të provimit, Formulari i vlerësimit të periudhës së provimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga vizita në institucion, nga studentët u pranua se disa pedagogë ofrojnë sesione për rishikim lënde përpara provimeve afatmesme dhe/ose para provimeve përfundimtare. Sesione të tilla rishikimi ofrojnë një mundësi për stafin akademik që të nxjerrë në pah konceptet më të rëndësishme nga lënda dhe t'i udhëzojë studentët në zbatimin e tyre në provime ose projekte. <i>Takimi me studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Nga ana e stafit të programit të studimit u pohua se realizohen leksione të hapura për zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit prej stafit të ftuar ose PAE. Në workshope ftohen edhe studentët të paraqesin rezultatet e punëve të tyre.</p>

jashtë strukturës së programit të studimit.	<i>Takimi me studentet</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sipas aktiviteteve përshkruar në syllabuse, mësimdhënia zhvillohet në bazë të kompetencave për t'u ofruar studentëve mundësinë që të zhvillojnë kompetencat e tyre në praktika. Edhe pse nuk specifikohet, kjo nënkupton edhe zhvillim laboratorësh në varësi nga lloji i lëndës. Studentët kanë një laborator të dedikuar për Elektronikën për të zhvilluar projektet e tyre.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik i programit të studimit pohoi se synojnë të nxisin mendimin kritik tek studentët, mbështetin diskutimet dhe punën në grup si dhe kërkojnë prej studentëve të përqëndrohen në interpretimin dhe më pas në zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Që të mundësohet zbatimi sipas kriterit 7, personeli akademik pohon se i kushtojnë vëmendje krijimit të klimës së përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore. Kjo lehtësohet prej faktit se studentët janë në moshë më të pjekur dhe kanë kërkesa tepër të larta për arritjet e pritshme të tyre. Studentët kanë qenë të përfshirë në projekte kërkimore nën mbikëqyrjen e stafit akademik të departamentit. Ata janë mbështetur nga Komisioni Evropian dhe menaxhojnë punën kërkimore për projektet Horizon 2020 nën kuadrin e Kërkimit dhe Inovacionit. <i>DVV Evidencë:</i> https:// www.panbiora.eu/
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Universiteti EPOKA ofron mbështetje financiare për personelin akademik dhe studentët për t'i mundësuar ata të marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe në publikime. Në bazë të rregulloreve të Universitetit EPOKA, studentët e masterit të programit të Inxhinierisë Elektronike dhe Komunikimit janë mbështetur financiarisht si Asistentë Projektesh me kohë të pjesshme gjatë studimeve të tyre për të punuar në projektet Horizon 2020 dhe në projekte të tjera në vazhdim. Mbështetja financiare që u mor nga studentët master përfshin koston e personelit për kohën e tyre dhe kontributin e tyre në kërkimin dhe blerjen e pajisjeve për eksperimentet që ata do të kryenin. <i>DVV Evidencë:</i> <i>Aneks 51, Aneks 52</i>
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	UE dhe DIK synon kombinimin e formave të mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e mobilitetit CEEPUS, Erasmus+ dhe Fulbright që mundësojnë vizita afatshkurtra dhe afatgjata të stafit akademik dhe gjatë këtyre lëvizjeve studentët ndeshen me forma të ndryshme të mësimdhënies që do t'i bënin studentët më të adaptueshëm për programet e mobilitetit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Universiteti EPOKA ka hartuar kërkesat e diplomimit të cilat paraqiten në rregulloren e UE, rregulloren e Programit të studimit të ciklit të dytë dhe I bëhen të ditura studentit prej publikimit në faqen e internetit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Udhëzimet e përgatitjes së tezës janë gjithashtu të disponueshme në internet. <i>DVV Evidencë: Annex 53</i> , https://sites.google.com/a/epoka.edu.al/cen-student-wiki/thesis-guidelines
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët e programit të studimit Master I shkencave “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” diplomohen me punimin dhe mbrojtjen e një teze. Udhëzimet për tezën e masterit ofrohen nga faqja zyrtare e internetit e departamentit dhe personalisht. Studentët e Masterit të Shkencave asistohen prej një këshilltari akademik i cili i këshillon ata për të gjitha aspektet e mbrojtjes së diplomës. Këshilltarët udhëzojnë studentët në procesin e përgatitjes së tezës për detyrat përkatëse të diplomimit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i studimit Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” nuk zbaton provim final për studentët që diplomohen. Gjatë përgatitjes së tezës, studentët duhet të kontaktojnë mbikëqyrësin çdo javë me udhëheqësin dhe të konfirmojnë punën e bërë. Në fund, studenti duhet të prezantojë punën e tij në juri, e cila vepron si komision që vendos nivelin shkencor të punimit të diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Nga takimi me studentët u konfirmua se Staf i akademik udhëzon dhe ndihmon studentët në përzgjedhjen e temës dhe në përgatitjen për punimin e diplomës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti EPOKA ndihmon studentët në kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve brenda ose jashtë ambienteve të institucionit. Për të mundur marrjen e të dhënave, UE financon blerjen e instrumenteve përkatëse eksperimentale, të njësisive llogaritëse me fuqi të lartë, kryerjen e studimeve ndërdisiplinore si bashkëpunimi me laboratorët e kimisë dhe biologjisë etj. Me kontributin e studentëve të masterit në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni janë ndërtuar qarqe në miniaturë që kanë gjetur aplikim në mikrofluidikë. Financimi bëhet i mundur nëpërmjet fondeve të jashtme dhe të brendshme me projektet e Erasmus+, fondet e projektit Horizon 2020 etj. Institucioni, nën drejtimin e Zyrës së Kërkimeve dhe Projekteve, hap periodikisht thirrje për financim për projekte të brendshme.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 58


	<i>DVV Evidencë: https://projects.epoka.ed.u.al/home-research-p-rojec-ts-3rd-call-2673-2574.html</i>			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Mbikëqyrësi i temës së masterit i udhëzon studentët në procesin e kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të tezës së tyre. Ata vendosin një temë gjatë semestrit të tretë të programit të studimit master, gjatë marrjes së lëndës Term Project. Më pas, në semestrin e katërt, udhëheqësi drejton studentin në kryerjen e një pune kërkimore duke iu bindur kërkesave të nevojshme. Mbikëqyrësi vlerëson nëse studenti mund të mbrojë punën e tij/saj dhe më pas e miraton studentin për prezantimin e punës para jurisë. <i>DVV Evidencë: Vizita në UE, takimi me stafin e DIK</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me note, që pasqyrojnë performancën e tyre kërkimore e shkencore në temën e masterit.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Kur studentët plotësojnë kërkesat e procedurës së diplomimit si : <ul style="list-style-type: none"> • kërkesat për kredite ECTS dhe • kërkesat për notën mesatare minimale, Zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentët. Pas diplomimit, Zyra e Regjistrimit ofron diplomë dhe suplement diplome për studentët e diplomuar sipas afateve dhe rregulloreve. <i>DVV Evidencë: 54 dhe 55.</i>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët janë të informuar për programin e studimit dhe mund të planifikojnë programin e tyre të studimit bazuar në kurrikulën e disponueshme. Studentët regjistrohen në kurse dhe ndjekin notat dhe transkriptin e tyre përmes EIS. Studentëve u jepet një transkript zyrtar që tregon notat e tyre dhe të gjitha kurset që kanë përfunduar pas diplomimit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Dokumentacioni i të dhënave të diplomimit të studentëve dhe performancës së tij ruhet për një periudhë të pacaktuar nga Departamenti dhe Zyra e Regjistrimit dhe Arkivën e UE. Dëshmia e një dokumentacioni të tillë disponohet në zyrat përkatëse dhe i jepet studentit në se kërkohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në organigramën e Institucionit të Arsimit të lartë, “Universiteti EPOKA” ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për dokumentimin dhe ndjekjen procedurale të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të angazhuar në institucion. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia dhe rifreskimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Në dosje ishin të përditësuara edhe të dhënat e leje- qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë për staf akademik të huaj të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Dosjet e kontrolluara përmbanin: ID, CV, lejeqëndrimi (për shtetasit e huaj), librezë shëndetësore, format aplikimi, kontratë mes palëve, certifikata të titujve dhe gradave shkencore me njehësimet përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin në rastin kur janë lëshuar nga institucione të huaja.</p> <p>Nga zyra e burimeve njerëzore vihet re një organizim i mirë i informacionit të brendshëm e cila bazohet në një sistem informatik si për regjistrimin e dosjeve dhe të dhënave dixhitale ashtu edhe për referenca praktike në ato fizike dhe vendndodhjen e tyre në arkivë.</p> <p><i>DVV Evidencë: 1 Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 58 Regulation_Staff_Recruitment</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Minuta takimi EPOKA</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka të hartuar një rregullore të brendshme për rekrutimin e stafit akademik, ndihmësakademik dhe atë administrativ. Bazuar në këtë rregullore, nevojat për staf paraqiten nga departamentet përkatëse të cilët përcaktojnë edhe kualifikimet apo kriteret që kërkohen nga stafi i ri. Këto akte rregullatorë janë publike në faqen zyrtare ueb të institucionit.</p> <p><i>DVV Evidencë: 58 Regulation_Staff_Recruitment</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e rekrutimit të stafit në institucionin EPOKA, kriteret dhe nevojat për staf hartohen fillimisht në nivel departamenti dhe më pas i kalojnë hierarkisë institucionale si fakultet e më pas si universitet. Në bazë të miratimit të kërkesës së departamentit, zyra e burimeve njerëzore ndjek të gjithë procedurën administrative dhe</p>

	<p>logjistike nga marrja e kërkesave të departamenteve, shpallja e vendeve të lira, mbledhja e dokumentacionit nga kandidatët dhe deri në përfundim të procesit të rekrutimit.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore, e cila ka një faqe të personalizuar në domainn e vet universitetit me të gjitha informacionet e nevojshme për çdo punë kërkuar, në bazë nevojave shpall njoftime për pozicione vakante në faqen ueb zyrtare të institucionit. Nga konsultimi i faqes ueb të zyrës së burimeve njerëzore(https://hr.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html) rezultojnë disa vende vakante në stafin akademik dhe administrativ. Sikurse u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion, edhe në rastet kur nuk ka njoftime aktive, publikohet një informacion për këdo që është i interesuar dhe mendon se plotëson kriteret e kërkuara nga institucioni, mund të aplikojë edhe pa patur vende vakante. Në këtë rast, zyra e burimeve njerëzore, në vartësi të aplikimeve që mund të jenë, informon departamentet që mund të jenë të interesuara për profilin e kandidatëve që mund të kenë aplikuar edhe në mungesë të një vendi efektiv vakant. Në të njëjtën kohë nga IAL publikohet dhe një udhëzues informues për personelin e IAL dhe kandidatët e interesuar(https://epoka.edu.al/mat/staff_guide.pdf).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Zyra e burimeve njerzore në Universitetin EPOKA ndjek të gjithë procedurën administrative për rekrutimin e stafit të ri. Njoftimet për vende vakante së bashku me kriteret specifike akademike të hartuara nga departamentet, bëhen publike në faqen ueb të zyrës së burimeve njerëzore. Nga konsultimi i infromacionit të publikuar në faqen zyrtare të IAL rezultonin njoftime aktive për personel akademik dhe administrativ, por kishte njoftime joaktive ose të mbyllura më parë.</p> <p>Bazuar në aplikimet e mundshme dhe shqyrtimin e dokumentacioneve të paraqitur nga kandidatët, zyra e burimeve njerëzore kryen një vlerësimin paraprak të tyre. Kandidatët e përzgjedhur ftohen të zhvillojnë një seancë dëgjimore (leksion të hapur) përpara stafit akademik aktual të universitetit. Kjo procedurë shërben për të vlerësuar aftësitë e kandidatit për të përçuar dijet si dhe aftësinë e tij për të komunikuar në gjuhën angleze në nivele të kuptueshme nga studentët.</p> <p>E gjithë procedura e vlerësimit kryhet nga Komiteti Shkencor i njësisë bazë që ka shpallur pozicionin vakant. Objektiviteti i vlerësimit të kandidatëve vërehet edhe në skedën e pikëzimit përkatëse të përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>DVV Evidencë: 58 Regulation_Staff_Recruitment</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 61 Academic Staff Application Form</i></p> <p><i>Annex 62 Academic Staff Recruitment Form</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 63 Administrative Staff Application Form</i></p> <p><i>Annex 64 Adminsitrative Staff Recruitment Form</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Universiteti EPOKA zhvillon aktivitetin në kampusin universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, Km. 12. Ambientet e këtij kampusi universitar përfshijë ambiente zyresh për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, ambiente mësimdhënje (salla leksioni dhe seminari), ambiente laboratorike, bibliotekë, menxë dhe ambiente të tjera ndihmëse dhe shplohëse.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, përtej paraqitjes në DVV, vihet re që të gjitha ambientet në funksion jo vetëm të këtij programi studimi, kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin efektiv të të gjithë procesit didaktik.</p> <p>Universiteti EPOKA ka venë në dispozicion të studentëve/ stafit një bibliotekë me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tabelat 16 dhe17)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Gjatë takimeve në institucion, në veçanti me stafin akademik, me përfaqësues të zyrës së sigurimit të cilësisë dhe në takimin me përfaqësues drejtues të institucionit dhe të programit të studimit, u nënvizuan politikat mbështetëse dhe promovuese të zbatuara nga IAL. Politikat promovuese janë të sanksionuara edhe në direktiva të brendshme të institucionit.</p> <p>Kjo vihet re edhe nga publikimet e arritura nga stafi i institucionit i cili paraqitet në nivele të larta të publikimeve në përgjithësi dhe në veçanti të atyre me faktor impakti të cilat gjatë vitit të fundit (2020 dhe 2021) kanë patur një rritje gati me 50%.</p> <p>Një nga mënyrat që institucioni përdor për të motivuar stafin është ai financiar i cili bazohet në arritjet e stafit në publikime shkencore dhe pjesëmarrje në projekte. Sa më të larta të jenë rezultatet e arritura aq më i lartë është edhe shpërblimi financiar. Rregullat e brendshme të kësaj procedure janë transparente për të gjithë stafin</p> <p><i>Annex 50 Directive "On the promotion of scientific publications"</i> <i>Annex 19 Directive_Acad_Admin Perfor Assess_Quality Improv</i> <i>DVV Evidencë: 3.1.Kerkimet Shkencore.The List of Scientific Publications</i></p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Kjo vërehet edhe në angazhimin e institucionit për të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme në zhvillimin modern të mësimdhënies (si</p>

<p>përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>vendosja e tabelave interaktive në thuasje çdo auditor apo edhe i sistemeve të video-konferencës në rastet e pjesëmarrjes në aktivitetin didaktik të personave që ndodhen jashtë institucionit.</p> <p>Në periudhën e vështirësive objektive për të gjitha IAL-të, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e SARS-Cov-2, Universiteti Epoka ka rritur angazhimin në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie online direkt nga auditorët e shkollës. Gjithashtu, së bashku me mësimdhënien klasike, një pjesë e leksioneve të regjistruara nga stafi akademik, bëhen publike dhe në rrjetet sociale (si youtube) të aksesueshme nga studentët por jo vetëm.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të rritjes së cilësisë së brendshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor organizohen aktivitete të ndryshme trajnuese. (http://aeqi.EPOKA.edu.al/cat-training-activities-1411.html)</p>												
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Universiteti EPOKA kë të miratuar në rregulloret e brendshme procedurat dhe kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis stafit akademik.</p> <p>Të dhënat me ngarkesën totale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë edhe ngarkesën në programe të tjera studimi të institucionit për vitin aktual akademik (2021-2022) janë dhënë në Tabelat 4 dhe 12 (<i>Tabelat përmbledhese MSc ECE_sq</i>) e RVB dhe ngarkesa e përmbledhur rezulton si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="730 996 1289 1187"> <thead> <tr> <th>Statusi PAE/PAK</th> <th>Ngarkesa në orë (min – max)</th> <th>Ngarkesa mesatare në orë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>PAE</td> <td>288 – 560</td> <td>378</td> </tr> <tr> <td>PAK</td> <td>352</td> <td>352</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në Udhëzim nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrit përgjegjës për arsimin, Kreu III, pika 5, IAL nuk ka një kufizim ligjor mbi ngarkesën maksimale të lejuar për stafin akademik në IAL jopublike.</p> <p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e kërkuar dhe të nevojshëm për lëndët që mbulon. Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave në tabelat 6.1-6.6 (<i>Tabelat përmbledhese MSc ECE_sq</i>) e RVB dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon që ngarkesa e stafit akademik të zvogëlohet në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Në këtë mënyrë mund të rritet angazhimi i stafit në projekte kërkimore ku përftimet e kërkimeve dhe njohurive do të mund të pasqyrohen edhe në dijet e përçuara tek studentët.</u></i></p>				Statusi PAE/PAK	Ngarkesa në orë (min – max)	Ngarkesa mesatare në orë	PAE	288 – 560	378	PAK	352	352
Statusi PAE/PAK	Ngarkesa në orë (min – max)	Ngarkesa mesatare në orë											
PAE	288 – 560	378											
PAK	352	352											
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>									
				<p>X</p>									





Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktikë e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në DVV si dhe nga evidentimi gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Universiteti EPOKA siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse përkatësisht afro 7.4 m² për student dhe 20.1 m² për personelin .</p> <p>Universiteti EPOKA zhvillon aktivitetin didaktik brenda kampusit universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, km 12. Në këtë kampus ndodhen tre godina. Godina e parë ka kryesisht ambiente administrative, auditorë/salla leksionesh/seminaresh, laboratorë didaktik. Godina e dytë ka kryesisht ambiente leksionesh, mense/bar, bibliotekën dhe ambiente ndihmëse. Godina e tretë është konvikt studentor.</p> <p>Përveç ambienteve të dedikuara për mësimdhënie si salla leksionesh dhe laboratorë dhe biblioteka, vlerësohet shumë pozitive edhe nga studentët prania e ambienteve ndihmëse si bar- restoranti apo ato sportive.</p> <p><i>DVV Evidencë: 30 Summary Table for Infrastructure</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tabela 16)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu sallat ishin pajisur edhe me sistem video-konference/ kamera për regjistrimin dhe stream-in e leksioneve në kohë reale në platformat e mësimin online si pasojë e zhvillimit të procesit didaktik online të diktuar nga situata e pandemisë Covid-19.</p> <p>Një pjesë e auditorëve ishin të pajisur edhe me tabela interaktive në funksion të një mësimdhënie inovative dhe më gjithëpërfshirëse. Staf i IT mirëmban dhe asiston stafin akademik në mirëpërdorimin e pajisjeve teknologjike të vëna në dispozicion.</p> <p><i>DVV Evidencë: 30 Summary Table for Infrastructure</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të</p>	<p>Bazuar edhe nga vizita në institucion, Universiteti EPOKA ka tre laboratorë që mund të përdoren në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>Dy janë laborator elektronik me pajisje matëse dhe testimi të sinjaleve dhe pajisjeve elektronike si FPGA, DSP, miktokontroller etj. Fizikisht këto dy laboratorë ndodheshin brenda të njëjtës salle të ndarë me dollap njëri nga</p>

<p>moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>tjetri. Laboratori është i pajisur me të gjithë strumentat e nevojshëm për një post laboratorik si: Oshiloskop dixhitale, Gjenerator sinjali (Disa janë edhe të frekuencës së lartë deri në 3GHz), analizator spektri deri në 3GHz, bllok ushqimi laboratorik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga studentët përdoret edhe një laborator i tretë që në momentin nuk ishte akomoduar plotësisht dhe përfundimisht, ku ishin të instaluar një pjesë e pajisjeve elektronike të përfuara nga projekte ku institucioni është i angazhuar.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ofron edhe laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilët kanë të instaluar programe në funksion të programit të studimit. Kompjuterët e këtyre laboratorëve paraqesin karakteristika teknike të mjaftueshme për të përballuar ngarkesën e kërkuar në simulime dhe aktivitete laboratorike të këtij programi studimi.</p> <p>Nga biseda me studentët, këto laboratorë aksesohen prej tyre jo vetëm gjatë orëve të parashikuara për lëndët përkatëse, por mund të aksesohen sa herë e kanë të nevojshme.</p> <p><i>DVV Evidencë: 30 Summary Table for Infrastructure</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Minuta takimi EPOKA</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për realizimin e veprimtarive praktike e profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon.</p> <p>Gjithashtu vihet re një angazhim në rritje të institucionit për të marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ku pjesëmarrja në këto projekte shihet si pozitive në tërësi për rritjen e nivelit të institucionit, stafit dhe studentëve. Në veçanti për studentët e këtij programi studimi shihet si mundësi e mirë për zhvillimin e veprimtarive praktike, profesionale dhe kërkimit shkencor në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>DVV Evidencë: 7 List of Institutional Cooperations</i></p> <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 30 Summary Table for Infrastructure</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Minuta takimi EPOKA</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni si dhe vizitën në institucion, Universiteti EPOKA disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 400m², të pajisur me një fond të gjerë librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Të dhënat e bibliotekës mund të aksesohen online nga i gjithë stafi dhe studentët në adresën ueb: https://library.epoka.edu.al/.</p> <p>Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme për konsultimin e literaturës fizike me rreth 100 vende (tavolinë/ karrige) për konsultim. Biblioteka Universitare EPOKA ofron akses të ndryshëm për studentët e saj nëpërmjet Bibliotekës Dixhitale në lidhje me të gjitha studimet programore të ofruara nga EPOKA. Biblioteka është e abonuar në disa burime elektronike si Science Direct e Elsevier, JSTOR, IOPscience, SCOPUS, Taylor dhe Francis, OECD-Library dhe Cambridge Journals Online.</p> <p><i>DVV Evidencë: 33 Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve të parashikuara për këtë program studimi dhe në literaturën e kërkuar, ajo gjendet në të paktën në një kopje fizike në bibliotekën e institucionit. Për pjesën më të madher të literaturës, institucioni ka edhe kopjen në format elektronik. Literatura e kërkuar dhe e rekomanduar për këtë program studimi është e gjitha në gjuhën angleze. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe nuk përbën pengesë për këtë institucioni dhe në veçanti për këtë program studimi pasi ai zhvillohet i gjithi në gjuhën angleze. Gjetja e librave në gjuhën shqipe për këtë program studimi, duke qenë ai dinamik dhe në evolucion shumë të shpejtë në rang botëror, do të sillte literaturë të vjetërsuar për vetë kohën që një literaturë në këtë fushë kërkon që të përkthehet/përshtatet në gjuhën shqipe.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdimësi të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.</u></i></p> <p><i>DVV Evidencë: 32 ECE books</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç bibliotekës fizike të pajisur me libra dhe poste akses online dhe poste studimi, institucioni garanton qasje online në koleksionet JSTOR specifike për materiale të lidhura me programet e studimit të ofruara nga Universiteti EPOKA.</p> <p>Menaxhimi i bibliotekës si katalog, sistem prenotimi, hua-marrje e literaturës etj, ofrohet nëpërmjet një sistem menaxhimi dhe informimi të personalizuar (https://library.epoka.edu.al/cat-regulations-484.html) nga ku mund të konsultojnë gjendjen e librave, mundësitë e leximit të tyre në</p>




	ambientet e bibliotekës apo të marrjes së tyre të përkohshme jashtë ambienteve të bibliotekës.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<p>Biblioteka ofron të gjitha kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Ambienti është <i>open-space</i> me libra në raftet e organizuara sipas klasifikimit LC (ndarje sipas argumenteve të trajtuar).</p> <p>Ofrohen rreth 100 poste konsultimi me sistem kondicionimi. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p> <p>Gjithsesi, biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi, nga çdo vend (IAL apo edhe nga shtëpia) me kredenciale aksesit të autorizuar nga institucioni.</p> <p><i>DVV Evidencë: 30 Summary Table for Infrastructure</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 33 Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Institucioni ka një procedurë të brendshme për planifikimin dhe shtimin e fondit të librave/revistave dhe materialeve të tjera të bibliotekës. Kryesisht procedura për shtimin e zërave të bibliotekës kalon nga nevoja e përdoruesve të bibliotekës të cilët paraqesin formularin e aplikimit tek përgjegjësi i njësisë përkatëse, dhe lista totale më pas aprovohet nga Administratori i Institucionit i cili autorizon shtimin e fondit të bibliotekës. Procedura më pas ndiqet nga zyrat përkatëse për prokurimet.</p> <p><u><i>GVJ rekomandon se IAL duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Master i shkencave "Inzhinieri Elektronike dhe Komunikacioni sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.</i></u></p> <p><i>DVV Evidencë: Procedura e pasurimit të bibliotekës</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Fatura e librave</i></p>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	<p>Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë – E Premte, 08:30 - 16:30. Qasja në bibliotekën fizike është i mundur 5 ditë në javë me orare të afishuara publikisht si në hyrje të bibliotekës ashtu edhe në faqen ueb përkatëse.</p> <p>Këto orare janë të përshtatshme edhe me sistemin e transportit dhe të aksesit në institucion. Biblioteka online është e aksesueshme 24 orë nga çdo post nga interneti. (https://library.epoka.edu.al/cat-regulations-484.html)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përbushje	Përmbushje pjesërisht	Përmbushje kryesisht	Përmbushje plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka e bazon menaxhimin e sistemit të brendshëm informatik në disa platforma të ndara logjikisht në platforma të përshtatura për mësimdhënie si moodle, të përgjithshme komunikimi dhe IT si platforma GSuite (platforma Google), office 365 (Microsoft) dhe një platformë e krijuar dhe mirëmbajtur nga stafi IT i vet institucionit i quajtur EIS = EPOKA Interactive System. (http://eis.epoka.edu.al/)</p> <p>Menaxhimi i të gjithë informacionit të brendshëm i përfshin të gjithë: anën administrative (zyra e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, zyra e projekteve etj.) dhe anën akademik (stafi akademik, studentët etj) dhe realizohet përmes platformës së sistemit të menaxhimit të informatizuar(EIS). Përdorimi i platformës së informatizuar shoqërohet me administrimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.</p> <p>Përdorimi i sistemit të informatizuar është në ndihmë edhe të sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra. Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e sekretarisë pasi edhe vendndodhja e dokumenteve fizik në institucion është një e dhënë e këtij sistemi që ndihmon personelin për reflektimin e dokumenteve zyrtar edhe në dosjen e gjithsecilit student/staf.</p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 34 EIS GuideLine - Students-Draft</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 35 EIS GuideLine - Lecturer-Draft</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën <i>Google</i> e cila lejon përdorimin e adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain @epoka.edu.al.</p> <p>Sistemi EIS i institucionit është hierarkik dhe me privilegje në bazë të rolit që çdo personel akademik/administrativ apo në çfarëdo roli që ka në institucionin, ka qasje në sistemin EIS dhe të dhënat e ruajtura në të sipas funksionit fizik që mbulon. Kjo garanton edhe privatësinë e qasjes të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi sikurse edhe lirinë akademike dhe të vlerësimit për të gjithë stafin.</p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 34 EIS GuideLine - Students-Draft</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 35 EIS GuideLine - Lecturer-Draft</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>I gjithë sistemi informatik, si ai i ndërtuar dhe mirëmbajtur nga vet institucioni, si ato të përdorura nga platforma komerciale si Google apo</p>

<p>gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Microsoft të përdorura nga Universiteti Epoka, kanë qasje nazuar në përdorues/ fjalëkalim.</p> <p>Bazuar në privilegjet dhe hierarkinë e përdoruesit, garantohet edhe qasja në informacionet e menaxhuara. Më saktësisht, pedagogët kanë qasje në vetëm të dhënat personale dhe në lëndët që mbulojnë. Përgjegjësi i departamentit ka një qasje më të gjerë si për lëndët ashtu edhe për raportet dhe vlerësimin e stafit nga studentët. Të gjithë përdoruesit kanë qasje në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë disa prej tyre si CV, foto etj.</p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 34 EIS GuideLine - Students-Draft</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 35 EIS GuideLine - Lecturer-Draft</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përdorimi i platformës Google Suite e cila përfshin Google meet; platformës Microsoft Office 365 me platformën Microsoft Teams, platform moodle dhe EIS lejojnë komunikimin interaktiv të përdoruesve. Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik, vlerësimet përkatëse, materialet e lëndëve të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen vetëm nga studentët përkatës në sistem të bazuar në platformën moodle. [http://lms.epoka.edu.al/]</p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi interaktiv EIS lejon plotësimin e pyetësorëve apo formularë të nevojshëm për menaxhimin e brendshëm të fluksit të punës dhe aktivitetit administrativ si për studentët ashtu edhe për stafin.</p> <p>Ndër pyetësorët që mund të plotësohen në platformë është dhe vlerësimi i pedagogut nga studentët, vlerësimi i studentit ndaj institucionit, etj. Gjithashtu në sistemin e informatizuar janë të dhënat akademike si nota, praktika, herët që një student ka dhenë një provim të caktuar etj.</p> <p>Bazuar në këto të dhëna, sistemi është në gjendje në mënyrë të automatizuar ti përpunojë dhe të krijojë raporte përmbledhëse: mbi kalueshmërinë, apo vlerësimin mesatar të studentëve, përdorimi i auditorëve dhe ambienteve laboratorike në bazë orareve apo të tjera.</p> <p><i>DVV Evidencë: 17 Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 76 Student Satisfaction Survey</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Universiteti EPOKA ka të përcaktuar që në statut përdorimin e faqes ueb zyrtare për afishimin e informacionit të senatit akademik , Neni 21, i statutit “Announcing, signing and publication of Academic Senate decisions”. Informacionet e afishuara në këtë faqe janë në dy gjuhë, atë angleze dhe shqipe. Informacione kryesore gjenden në faqe (http://www.epoka.edu.al/) dhe më të detajuara gjenden në faqet dytësore (domain sekondar) ku gjenden të dhëna për programet specifike të studimit ku në rastin e programit të studimit nën vlerësim, informacioni arrihet në faqen web.</p>

	https://cen.epoka.edu.al/home-msc-in-electronics-and-com-1944-1945.html]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6																						
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dispozicion të GVJ pasi u kërkua gjatë vizitës në institucion, u vendos në dispozicion raportet financiare 2016-2020 të audituesit të pavarur të "Turgut Ozal Education sh.a". ku pjesë e saj është dhe Universiteti EPOKA. Bazuar dhe në të dhëna dhe ato të deklaruara në raportet vjetore institucionale për vitet akademike nga 2016-2021 në kapitullin 5 të secilit raport jepet një përmbledhje e shpenzimeve operative për secilin vitin akademik dhe kostos për student në IAL së bashku me projekt- buxhetin e miratuar</p> <p><i>DVV Evidencë: Raporte 2016-2020</i></p> <p><i>DVV Evidencë: RAPORTET_VJETORE_2016-2021</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Miscellaneous revenues and financing</i></p>																					
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në raportet vjetore vihet re një analizë analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucioni. IAL ka hartuar planin e financimit në nivel institucional dhe fakultetesh dhe jo sipas programeve të studimit, ku janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe financimet e ndryshme, si dhe shpenzimet e kostove të studimit, kjo e raportuar me arsyetimin jo vetëm nga përmasat e institucionit por edhe me faktin se personeli në shumicën e rasteve angazhohet në programe të ndryshme studimi dhe për këtë arsye ka qenë e vështirë hartimi i tyre sipas programeve të studimit, ku vihet re që janë rritur të ardhurat ndër vite 2016-2021, që janë kryesisht nga tarifa për dhe gjatë shkollimit. Një pjesë e tyre nga e cila përfiton dhe programi i studimit janë të ardhurat nga projektet për vitet 2018-2021. Nga të dhënat në nivel IAL shpenzimet për studentët, për vitin 2016-2020 janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2016-2017</th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Shpenzimet operative (Euro)</td> <td>2,022,610</td> <td>2,578,124</td> <td>3,071,398</td> <td>3,012,946.50</td> <td>3,309,153.37</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Kosto për student (Euro)</td> <td>1462</td> <td>1591</td> <td>1793</td> <td>1,648</td> <td>1,532</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>		2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Shpenzimet operative (Euro)	2,022,610	2,578,124	3,071,398	3,012,946.50	3,309,153.37	-	Kosto për student (Euro)	1462	1591	1793	1,648	1,532	-
	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022																
Shpenzimet operative (Euro)	2,022,610	2,578,124	3,071,398	3,012,946.50	3,309,153.37	-																
Kosto për student (Euro)	1462	1591	1793	1,648	1,532	-																

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 70

Nr.studenteve	1383	1620	1713	1828	2160	-
Grante të projekteve të kërkimit	PANBIORA (Horizontal)	80,00	80,00	80,00	80,00	80,00
	DITV (Erasmus CBHC)	25,00	25,00	25,00	-	-
	V-Tech (Erasmus CBHC)	-	-	25,00	25,00	25,00

Në raportin vjetor institucional 2020-2021 janë raportuar të ardhurat dhe financimet e ndryshme, si afro 97 % e të ardhurave janë nga tarifat për dhe gjatë studimeve . Për vitin akademik 2021- 2022, të ardhurat janë parshikuar të jenë në masën afro 97,4 % nga “Tarifat për dhe gjatë shkollimit” dhe afro 2,6 % “Të ardhura të tjera”. Shpenzimet operative më së shumti mbulojnë në masën 57 % pagat dhe shperblimet e personelit, si dhe sigurimet, 29 % “Blerja e mallrave dhe shërbimeve” dhe afro 8.9 % për “Shpenzime për Kërkim dhe zhvillim”.

DVV Evidencë: Raporte 2016-2020

DVV Evidencë: RAPORTET_VJETORE_2016-2021

DVV Evidencë: Miscellaneous revenues and financing

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

Sipas RVB, Universiteti EPOKA kryen audit të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi si pjesë e shoqërisë “Turgut Ozal Education sh.a”.

Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës).

GVJ pati akses vetëm në vetë deklaratimet e institucionit në raportet vjetore institucionale të cilat janë depozituar në DVV si dhe publike në faqen ueb të institucionit. Gjithashtu u vendos në dispozicion një raport i audituesit të jashtëm për vitin kalendarik 2016-2020

Raporti hartohet nga drejtorja e Përgjithshme e shoqërisë “TurgutOzal Education Sh. A.” ku dhe IAL “Universiteti Epoka” është pjesë.

Megjithatë, nuk kishte një raport të detajuar për vlerësimin ekonomik në nivel programi studimi në veçanti.

DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tabela 18)

DVV Evidencë: Raporte 2016-2020


DVV Evidencë: RAPORTET_VJETORE_2016-2021

DVV Evidencë: Miscellaneous revenues and financing

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Bazuar në raportet zyrtare financiare si: Pasqyra e të Ardhurave dhe deklarata e Shpenzimeve të Institucionit, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar i cili siguron përparimin e institucionit. Në këtë mënyrë institucioni nga pikëpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv duke qenë se ka një bilanc pozitiv. Gjithsesi burim kryesor i të ardhurave të institucionit është nga tarifat për dhe gjatë studimit dhe një pjesë e vogël nga pagesat e studentëve për shërbimet e tjera.</p> <p><u>GVJ rekomandon që IAL të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.</u></p> <p>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tabela 18)</p> <p>DVV Evidencë: Raporte 2016-2020</p> <p>DVV Evidencë: RAPORTET_VJETORE_2016-2021</p> <p>DVV Evidencë: Miscellaneous revenues and financing</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>IAL “Universiteti Epoka” ka të miratur rregulloren bazë të IAL, e cila saktëson të gjithë procedurën administrative nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre dhe marrjen e diplomës përkatëse. Rregullorja është publike dhe e aksesueshme në ueb në adresën [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf]. Gjithashtu, të dhëna specifike për këtë program studimi jepen edhe në udhëzuesin e studentit.</p> <p><i>DVV Evidencë: 10 Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart Student Guide 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, bazuar edhe në statutin, dhe në veçanti në nenin 117, ka politikat dhe procedurat të qarta që garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët për student. Edhe rregulloret e programit të studimit dhe ato të brendshme si për përfaqësinë e studentëve janë gjithëpërfshirëse.</p> <p>Ndër kriteret e barazisë është edhe vlerësimi me meritë për bursat sipas kriterëve:</p> <p>1. Të diplomuar në Universitetin “EPOKA”:</p> <ul style="list-style-type: none"> • CGPA 2.70-2.99 - 10% zbritje; • CGPA 3.00-3.29 - 20% zbritje; • CGPA 3.30-3.49 - 30% zbritje; • CGPA 3.50-3.99 - 40% zbritje; • Në qoftë se CGPA është 4.00 ose renditet e para në programin e studimit Bachelor - 50% zbritje; <p>2. Të diplomuar nga universitete të tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> • CGPA 8.50 - 8.99 ose ekuivalente - 10% zbritje; • CGPA 9.00 - 9.49 ose ekuivalente - 20% zbritje; • CGPA 9.50 - 9.99 ose ekuivalente - 30% zbritje; • CGPA 10.00 - 40% zbritje; <p>Numri i bursave të akorduara në programin e studimit Msc ECE nga viti akademik 2016-2017 deri tek 2021-2022 është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2016-2017- 2 Bursa • 2017-2018- 1 Bursa • 2018-2019- 2 Bursa • 2019-2020- 4 Bursa • 2020-2021- 4 Bursa

	<ul style="list-style-type: none"> • 2021-2022- 5 Bursa <p>[http://admissions.epoka.edu.al/eat-scholarships-2745.html]</p> <p>Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton.</p> <p><i>DVV Evidencë: 15 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Lista si numer e mbeshtetjes financiare te studenteve te programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti Epoka, bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, çdo vit publikon kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve jo vetëm në këtë program studimi, por për të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Kriteret bëhen publike në faqen ueb zyrtare të institucionit në adresën (https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&dpid=2&t=master-of-science&catid=1928&memid=1930) dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.</p> <p>Në këtë program studimi për vitin 2021-2022(vjeshtë) ka pasur regjistrim të një studenti M.K nga programe të ngjashme (FSHN-UT), që është pranuar dhe regjistruar me vendim të komitetit shkencor të DIK, por duhet të marrë dhe disa lëndë mungesë (8) si pjesë e munguar e formimit Bachelor.</p> <p><i>DVV Evidencë: 66 Admission Criteria for Bachelor and Second Cycle Study Programs 2021-2022 academic year</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Procedura e pranimit te studenteve ne programin e studimit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Megi Kondi Accepted in MSC ECE.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, Universiteti Epoka harton kriteret specifike për çdo program studimi të ofruar prej tij. Kriteret bëhen publike në faqen e institucionit si dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit (https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html?lang=EN&dpid=2&t=master-of-science&catid=1928&menuid=1930)</p> <p>Për programin specifik Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni, për vitin akademik 2021-2022, kriteret e vendosura nga institucioni dhe të publikuar në faqen e IAL janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - > GPA se 2.5 nga 4 (>7 nga 10) - Niveli i zotërimit të gjuhës angleze B2 sipas CEFR.

	<ul style="list-style-type: none"> - Jepen kurse ekstra për studentët që vijnë nga fusha të ngjashme. <p>Kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të njohjes së gjuhës angleze në nivelin “B2” sipas CEFR (Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët) në një nga provimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cambridge - TOEFL Internet-based Test (iBT) - TOEFL Paper-based Test (ITP) - IELTS - TOEIC - GESE - APTIS <p>Kandidatët që kanë ndjekur studimet paraardhëse në anglisht prejashtohen nga ky kriter.</p> <p><i>DVV Evidencë: 69 Regulation-on-second-cycle-study-programs, article 13</i></p>								
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<p>Universiteti Epoka ka politika dhe udhëzime të brendshme që përcaktojnë mënyrën dhe modelet e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton edhe në institucione arsimore parauniversitare.</p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart Student Guide 2020-2021</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Studentët e këtij programi studimi, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve por edhe në statutin e institucionit si dhe në rregulloren e fakultetit dhe të programit të studimit, vlerësimi i dijeve bazohet në një sistem me pikë ku maksimumi i vlerësimit është 4.00. Në programet e të tre cikleve, në mënyrë që studentët të diplomohen, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Sistemi i vlerësimit të rezultateve të studentëve tek Universiteti EPOKA nuk është i bazuar tek kalimi i vitit, por tek kalimi i lëndëve në bazë semestrale. IAL ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti dhe me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon programin në fjalë, si dhe gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të</p>

	<p>mësimi. Në të njëjtën kohë syllabuset e lëndëve janë ngarkuar nga secili pedagog në platformat online.</p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart Student Guide 2020-2021</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 69 Regulation-on-second-cycle-study-programs</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 84 Guideline "On Examinations"</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 53 Thesis Guideline</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 49 Orientation Week Program</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni në zbatim të Udhëzimit Nr.18, datë 21.05.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloren bazë të IAL. Nuk ka pasur transferime nga programe Master të tjerë në këtë program studimi, por ka pasur 3 transferime nga ky program studimi në programe të tjera.</p> <p><i>DVV Evidencë: 68 Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat 21 dhe 23(Tabela 21)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar edhe në kriteret e kërkuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", në plan-programet e lëndëve janë të paraqitur mënyrat e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu informacione të përgjithshme jepen edhe në udhëzuesit e provimeve si për studentët ashtu edhe për lektorët.</p> <p><i>DVV Evidencë: 84 Guideline "On Examinations"</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Syllabus të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti takimi me përfaqësues të studentëve, vihet re një qasje transparente dhe informuese e institucionit kundrejt studentëve. IAL ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit, në mënyrë të përgjithshme për infrastrukturën në dispozicion të programit në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës ku paraqitet ky informacion. Studentët janë të qartë për procedurat dhe kriteret që duhen ndjekur për punimin e temës së diplomës, kriteret antiplagjaturë dhe rezultatet e pritshme që duhet të arrijnë. Në udhëzuesin e studentit jepen edhe të dhëna në lidhje me mënyrën e vlerësimit të sistemit anti-plagjaturë me anë të softuerit "Turnitin". Udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për ndjekjen e studentit gjatë zhvillimit cilësor të punimit deri në përfundimin e tij.</p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart Student Guide 2020-2021</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 53 Thesis Guideline</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 49 Orientation Week Program</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,</p>	<p>Organizimi i institucionit në nivel informimi është në disa hallka paralele të cilat informojnë studentin. Studentët në mënyrë periodike informohen</p>

<p>institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>me anë të njoftimeve me anë të postës elektronike. Një rol të veçantë në informimin e studentëve jo vetëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve por për cdo aspekt të lidhur me formimin e tyre, realizohet nga këshillimi me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit. Një rol të veçantë në informimin dhe udhëzimin e studentëve e zë edhe Këshilli i Studentëve [http://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html]. Të dhëna të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit.</p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart_Student_Guide_2020-2021</i></p> <p>Gjithashtu, bazuar edhe në statutin e IAL, neni 40 nga IAL, me vendim të Bordit administrativ është caktuar koordinatori akademik për këtë program studimi nga departamenti DIK që asiston dhe këshillon studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p><i>DVV Evidencë: Academic Coordinator</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët aktual, por edhe ata që parashikojnë të regjistrohen në këtë institucion, mund të marrin informacione të hollësishme në lidhje me strukturën akademike të ofruar nga institucioni. Në javën e parë të mësimit në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë e parashikuara formuese. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve edhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese dhe syllabuset e lëndëve, të cilat ngarkohen nga secili pedagog dhe në platformat online.</p> <p>Informacione të plota për këtë program studimi gjenden në faqen ueb (https://cen.epoka.edu.al/home-msc-in-electronics-and-com-1944-1945.html)</p> <p>Këto informacione publikohen edhe në udhëzuesin e studentit dhe gjithashtu edhe në raportet vjetore të hartuara nga institucioni në përputhje me kriteret ligjore të raportimit të aktivitetit vjetor.</p> <p><i>DVV Evidencë: 47 & 48 Smart_Student_Guide_2020-2021</i></p> <p><i>DVV Evidencë: RAPORTET VJETORE 2016-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Të dhëna specifike për modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese jepen në plan-programet e lëndëve. Të dhëna dhe materiale të lëndëve gjenden edhe</p>

<p>informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>në platformën online të institucionit ku studentët kanë akses në bazë përdorues/ fjalëkalim e ndërtuar në platformën "Moodle". (http://lms.epoka.edu.al/) Gjithashtu, udhëzues për studentët se si t'i përdorin dhe ku ti aksesojnë këto informacione janë të publikuara në faqen web të institucionit dhe gjithashtu gjenden edhe si udhëzues fizik.</p> <p><i>DVV Evidencë: Syllabus në DVV</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 34 EIS GuideLine - Students-Draft</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e regjistruar në këtë institucion kanë adresa të postës elektronike në domain të institucionit. Këto adresa përdoren, në mënyrë periodike për të shpërndarë informacione nga zyra e karrierës mbi mundësitë e punësimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Minuta takimi EPOKA</i></p> <p>Institucioni organizon çdo vit që prej vitit 2014 panairin e karrierës i cili për dy vitet e fundit është zhvilluar online si pasojë e kushteve të krijuara nga situata e pazakontë pandemike. Të dhëna të përditësuara gjenden edhe në faqen ueb të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe ALUMNI. (https://cpao.epoka.edu.al/#)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Platforma kryesore ku përditësohet i gjithë informacioni për studentët është faqja ueb e institucionit. Studentët kanë qasje të përditësuar në të gjithë informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e të gjithë procesit didaktik dhe jo vetëm. Në të gjenden dhe përditësohen të dhëna në lidhje me orari mësimor, plani mësimor, syllabuset e lëndëve (https://eis.epoka.edu.al/curricula/12/program), orari i transportit nga dhe për në institucion në linjën Durrës-Universitet dhe Tiranë-Universitet dhe anasjelltas (https://epoka.edu.al/)</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm të personalizuar me nevojat reale të menaxhimit të të gjithë informacionit si për stafin administrativ, atë akademik dhe për studentët. Aksesit në këtë sistem është në bazë të përdorues/fjalëkalim dhe mund të aksesohet nga kudo ku ka një qasje në internet. Ky sistem është i ndarë logjikisht në nën-sisteme si: EIS, Turnitin, Curricula, LMS, EPAS, Library, Open Akses të cilat mund të aksesohen lehtësisht nga faqja ueb kryesore: [http://www.epoka.edu.al/].</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin e informatizuar, platformë e krijuar dhe mirëmbajtur nga stafi IT i vet institucionit i quajtur EIS = EPOKA Interactive System. (http://eis.epoka.edu.al/)</p> <p>Në këtë platformë realizohet menaxhimi i të gjithë informacionit të brendshëm ku përfshihet: anaadministrative (zyra e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, zyra e projekteve etj.) dhe ana akademike (stafi akademik, studentët etj). Përdorimi i platformës së informatizuar</p>

	<p>shoqërohet me administrimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Përdorimi i sistemit të informatizuar është në ndihmë edhe të sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra. Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e sekretarisë pasi edhe vendndodhja e dokumenteve fizik në institucion është një e dhënë e këtij sistemi që ndihmon personelin për reflektimin e dokumenteve zyrtar edhe në dosjen e gjithsecilit student/staf.</p> <p><i>DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4															
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.															
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	<p>Numri i studentëve në të diplomuar për çdo program studimi të ofruar nga institucioni, dhe në veçanti për këtë program studimi janë paraqitur për gjashtë vitet e fundit në DVV dhe përkatësisht në (Tabela 23):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të diplomuar në këtë program studimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>11</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të dhëna statistikore për numrin e studentëve të diplomuar jepen edhe në raportet vjetore të paraqitura edhe në dosjen e vetë vlerësimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat permblledhese_MSc ECE_sq (Tabela 23)</i></p> <p><i>DVV Evidencë: RAPORTET VJETORE 2016-2021</i></p>			Viti akademik	Student të diplomuar në këtë program studimi	2016-2017	1	2017-2018	1	2018-2019	6	2019-2020	3	2020-2021	11
Viti akademik	Student të diplomuar në këtë program studimi														
2016-2017	1														
2017-2018	1														
2018-2019	6														
2019-2020	3														
2020-2021	11														
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	<p>Institucioni ka dhe përpunon të dhënat sasiore të regjistrimit/diplomimit/ largimit/ transferimit etj për studentët. Referuar edhe tabelave të paraqitura në DVV kemi studentë të regjistruar për herë të parë si:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të regjistruar në vit të parë</th> <th>Student të larguar</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>9.4</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>9.14</td> </tr> </tbody> </table>			Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Student të larguar	Nota mesatare	2016-2017	5	-	9.4	2017-2018	4	2	9.14
Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Student të larguar	Nota mesatare												
2016-2017	5	-	9.4												
2017-2018	4	2	9.14												

2018-2019	5	1	9.16
2019-2020	14	-	9.44
2020-2021	11	-	9.4
2020-2021	13	-	9.5
Në total	52	3	

Këto të dhëna gjenden edhe në regjistrin fizik të administruar nga sekretaria mësimore ku gjatë vizitës në institucion u konsultua regjistri përkatës, ku ishin të shënuara të gjitha, regjistrimet dhe largimet, pasi transferime nuk kishte në këtë program studimi etj.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me përgjegjësit e institucionit dhe ata të programit të studimit, u prezantua edhe aksesit në platformën e menaxhimit EIS. Qasja në modulën e raporteve bëhet e në bazë të privilegjeve që përdoruesi ka, por në të dalin raporte të hollësishme edhe për statistikën e avancimit akademik, tërheqjet apo largimet etj.

Këto raporte jepen edhe të përmbledhura në raportet vjetore të hartuara nga institucioni

DVV Evidencë: Tabelat përmbledhese_MSc ECE_sq (Tabela 21)

DVV Evidencë: RAPORTET VJETORE 2016-2021

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përmbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studentit në Universitetin EPOKA, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj.

DVV Evidencë: RAPORTET VJETORE 2016-2021

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re përdorimi efektiv dhe efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të brendshëm. Në këtë sistem ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me studentët që nga regjistrimi i tyre deri në përfundim të karrierës studentore. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Kjo formë shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik.

DVV Evidencë: 31 ICTC Office Services

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje

Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se Universiteti EPOKA i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të

dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse.</p> <p>Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni dhe publikohen dhe në faqen ueb të IAL</p> <p><i>DVV Evidencë:</i> Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq (Tabela 23)</p> <p><i>DVV Evidencë:</i> RAPORTET VJETORE 2016-2021</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në statutin e Universitetit EPOKA, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale.</p> <p>Në Universitetin EPOKA është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij. (http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/statute-of-student-council.pdf)</p> <p><i>DVV Evidencë:</i> 2 Statute-of-Epoka-University</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në statutin e Universitetit Epoka, në nenin 14 janë të përcaktuara organet kolegjiale si më poshtë (<i>DVV Evidencë:</i> 2 Statute-of-Epoka-University) :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Rektorati; - Dekanatet; - Asambletë e personelit akademik të njësisve kryesore; - Këshilli i Etikës; - Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; - Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët; - Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Bordi i Administrimit. <p>Në secilin prej këtyre organeve kolegjiale, studentët janë të përfshirë me përfaqësues të tyre. Prania e tyre është e sanksionuar edhe në Statutin e këshillit studentor [https://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html].</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 81


	<p>Studentët përveç pjesëmarrjes në organet kolegjiale të përmendura më sipër, janë pjesë e procesit të vlerësimit me anë të vlerësimeve periodike që plotësojnë si për stafin akademik ashtu edhe për institucionin dhe shërbimet e ofruara prej tij.</p> <p><i>DVV Evidencë: 17 Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 76 Student Satisfaction Survey</i></p>																																																																												
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Pas analizës së planit mësimor të këtij programi studimi (Tabela 10) paraqesin një ndarje korrekte të lëndëve në semestra dhe vite akademike, në kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tabela 10.1-10.6)</i></p> <p>Ndarja e orëve mësimore (në Auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="619 719 1342 1330"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Viti I (60 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti II (60 ECTS)</th> <th rowspan="2">Total ore / (120 ECTS)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>640</td> <td>860</td> <td>320</td> <td>1180</td> <td rowspan="2">3000</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> </tbody> </table> <p>Tabelat e planeve mësimore, të paraqitura në tabelat 10.1 – 10.6, të perditesuara nga IAL, paraqesin një ndarje korrekte të lëndëve në vite akademike, kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit. Gjithashtu, vërehet një ndarje e orëve në auditor për aktivitetet formuese në rreth 10 orë/ECTS. Gajtë vizitës, në takimin e parë me drejtuesit u informuam se në programet Master të ofruara nga Universiteti EPOKA, nuk ka lëndë të veçantë për praktikën profesionale, me vlerësimin që ka lëndë në kurrikul që lidhen dhe kanë praktikë mësimore</p> <p><u><i>GVJ rekomandon rishikimin e kurrikulës së këtij programi studimi duke shtuar si lëndë të veçantë “Praktikën profesionale”, minimalisht me 10 ECTS, në semestrin e dytë, një alternative duke ulur kreditet e tezës së diplomës.</i></u></p> <p>Në këtë program studimi nuk ka pasur raste të njohjes së studimeve të pjesshme.</p>	Viti akademik	Viti I (60 ECTS)		Viti II (60 ECTS)		Total ore / (120 ECTS)	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	2016-2017	640	860	320	1180	3000		1500		1500		2017-2018	640	860	320	1180	3000		1500		1500		2018-2019	640	860	320	1180	3000		1500		1500		2019-2020	640	860	320	1180	3000		1500		1500		2020-2021	640	860	320	1180	3000		1500		1500		2021-2022	640	860	320	1180	3000		1500		1500	
Viti akademik	Viti I (60 ECTS)		Viti II (60 ECTS)		Total ore / (120 ECTS)																																																																								
	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual																																																																									
2016-2017	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										
2017-2018	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										
2018-2019	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										
2019-2020	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										
2020-2021	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										
2021-2022	640	860	320	1180	3000																																																																								
	1500		1500																																																																										

	<i>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq(Tebela 21)</i>			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimmarrëse. Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinionëve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. IAL ka një politikë dhe procedurë për rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Ky program studimi është rishikuar në zbatim të VKM 41 , datë 24.01 .2018 për tipologjinë e lëndëve nga A, B, C, D, E dhe F në A, B, C, D dhe E. <i>DVV Evidencë: 6 Policy on Continuous Improvement of Study Program</i>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Studentët e këtij programi studimi, e pohuar edhe në takimin me përfaqësues të studentëve gjatë vizitës në institucion janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim. Në përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit. Nga takimi me studentët në institucion u vù re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin. <i>DVV Evidencë: 17 Course Instructor Evaluation Survey</i> <i>DVV Evidencë: 76 Student Satisfaction Survey</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nënvlerësohet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i shkencave "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" ka marrë pjesë në aktivitete kërkimore dhe shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën specifike që mbulojnë, në aktivitetet kërkimore të organizuara nga IAL ose universitete dhe qendra kërkimore në vende europiane dhe të tjera. IAL me objektiv kryesor të sigurojë pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitetet shkencore mbështet financiarisht personelin akademik. Kjo bazuar në 2 rregulloren përkatëse (<i>DVV Evidencë: 71 Directive 'On the Promotion of Scientific Publications'</i>) dhe <i>DVV Evidencë: 70 'The Regulation of Publication'</i>), ku personeli akademik mbështetet financiarisht nga buxheti i dedikuar

	<p>pë kërkimin shkencor ku përfshihen: pjesëmarrje në konferenca, workshop, seminare, kurse profesionale, publikimi i botimeve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dhënat e botimeve të stafit akademik të DIK që mbulon programin e studimit jepen në tabelat 19, 20 dhe 22 të (DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta ka nënshkruar marrëveshje partneriteti ndër vite me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. nën programin Erasmus + me IAL të huaja si : Technical University of Denmark , Lund University, Sweden, Aalborg University, Denmark, University Of Žilina, Slovak Republic, University of Salzburg Paris Lodron University, Austria, University of Genova, Italy, Polytechnic University of Bucharest, Romania, University of Ljubljana, Slovenia, University of Tartu, Estonia, VSB-Technical University of Ostrava, h Republika çeke etj. 2. nën programin Horizon 2020 me IAL e institute me qëllim realizimi projekte dhe kërkime të përbashkëta: Aalto University, Centre Hospitalier Universitaire de Liège, Dublin City University, University of Nottingham, CSIC, CEA Leti etj. <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 7 List of Institutional Cooperations</i></p> <p>Universiteti EPOKA ka hapur në vitin 2019 thirrjen e 3-të për projekte shkencore që mbështetej me një fond prej 400 000 ALL për projekt nga IAL dhe aplikatnët duhej të ishin doktorantët e regjistruar ne Universitetin EPOKA dhe që nuk kishin përfituar më parë fonde nga thirrjet e mëparshme.</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex 51-Epoka University _ 3rd Call for Internal Scientific Research Projects</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton që personeli akademik motivon dhe mbështet studentët në kërkimin shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca si psh ajo e organizuar nga Departamenti CONTESA në bashkëpunim me IAER, (http://www.contesa20.theiaer.org/) dhe (http://www.epoka.edu.al/news-2nd-ieee-contesa-conference-held-on-december-10-11-2021-at-epoka-university-5883.html) projekte tw IAL dhe ndërkombëtare dhe kërkime shkencore të departamentit. Në mënyrë të vecantë vlen të përmendet angazhimi</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. në projektin ndërkombëtar shkencor të Universitetit EPOKA me IAL dhe institute shkencore të tjera ndërkombëtare “PANBioRA- Personalized and/or Non-specific Biomaterial Risk Assessment via a fully integrated instrument”, ka zgjatur nga 2017-2021;

	<p>2. në projektin ndërkombëtar shkencor të Universitetit EPOKA me IAL dhe institute shkencore të tjera ndërkombëtare ERASMUS+ Project 2017 “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV curricula/ (DIMTV). Reference No.5863 18-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2- CBHE-JP (2017-2982/001-001), që zgjati nga 2017- 2020;</p> <p>3. në iniciativën ndërkombëtare shkencore të Universitetit EPOKA me IAL dhe institute shkencore të tjera ndërkombëtare COST Action CA16101 “MULTI-modal Imaging of FOREnsic Science Evidence - tools for Forensic Science “, që zgjati 2017 – 2021.</p> <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p>Në të njëjtën kohë IAL, ka angazhuar intensivisht studentët e këtij programi studimi dhe aktivitete të tjera shkencore të departamentit.</p> <p><i>DVV Evidencë: Table 22 Engagement of students in the activities of the unit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Info on engagement of students in the activities of the unit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Number of participants in scientific activities</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve shkencore të personelit akademik dhe studentëve e mbështetur dhe me buxhet nga IAL. Nga IAL në statut, direktivën e promovimit dhe mbështetjes së kërkimit dhe publikimit shkencor dhe rregulloren e publikimit inkurajon, mbështet financiarisht punën jo vetëm të personelit akademik por dhe angazhimin e studentëve. Gjithashtu nga IAL inkurajohet publikimi në revista shkencore me faktor impakti duke i caktuar dhe një bonus në vlera monetare sipas sistemit të pikëzimit dhe indeksit të revistës shkencore. Kjo u konfirmua dhe gjatë takimit me stafin drejtues të fakultetit dhe departamentit, si dhe atë akademik dhe Zyrën e Karrierës, Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare dhe nga dokumentacion i kërkuar dhe vënë në dispozicion nga IAL. IAL vë në dispozicion të çdo personeli akademik 1500 Euro për kërkimin dhe projektet shkencore. Staf i ri akademik mbështetët me një fond 750 Euro në vit për 3 vitet e para. Në vitin akademik 2019-2020 nga IAL u disbursua për shpërblimet e për proceset e kërkimit shkencor të personelit akademik 25000 Euro, ndërkohe që për vitin 2020-2021 kjo vlerë shkoi 50000 Euro. Ndërkohë rreth 200 000 euro janë investim në 5 vitet e fundit në laboratorin e elektronikës, i cili përdoret për këtë program studimi dhe për kërkimin shkencor.</p> <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Table 22 Engagement of students in the activities of the unit</i></p>




	<p><i>DVV Evidencë: Info on engagement of students in the activities of the unit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 3.1.Kerkimet Shkencore.The List of Scientific Publications</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq (Tabela 19 - Te dhena per kerkimin shkencor te stafit akademik, pi'rgjegji's pi'r programin e studimit)</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 13-14-15 DEC~1.PDF</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Dokumentim(12 dokumente) të mbështetjes financiare nga IAL për pjesëmarrje në konferenca, aktivitete shkencore dhe publikime</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	<p>IAL dhe njësia bazë, DIK motivon dhe mbështet studentët në angazhimin tyre dhe me pagese në studime inovative dhe patentave duke i përfshirë studentët në projekte ndërkombëtare në fushë, të Horizon 2020 dhe Erasmus+, si projekti PANBioRA të detajuara në kriterin 3 të këtij standarti. Kjo u konfirmua dhe në takimin me studentët e programit të studimit.</p>			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik, departamenti, koordinatori akademik dhe udhëheqësi i diplomës mbështet, udhëzon dhe asiston studentët në kryerjen e analizave, matjeve, studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës, e cila mbështetet nga pjesëmarrjet në projektet e IAL dhe infrastruktura e plotë laboratorike në fushë e IAL.</p> <p><i>DVV Evidencë: 8 Computer Engineering Department _ Epoka University.</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 10 Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Table 22 Engagement of students in the activities of the unit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Info on engagement of students in the activities of the unit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL ka ndjekur një politikë bashkëpunimi me IAL të tjera në vend dhe jashtë me qëllim rritjen e aktiviteteve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Fokusi kryesor në këto bashkëpunime janë kërkimi shkencor, projektet, inovacioni si dhe rritjen e mundësisë së punësimit të studentëve. Personeli akademik i Universitetit EPOKA dhe i IAL të huaja mbështeten në procesin e informimit për programet kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit të mobilitetit dhe institucionet shqiptare të kërkimit. Universiteti EPOKA ka rritur bashkëpunimin me IAL të tjera në kuadër të projekteve ndërkombëtare nën Erasmus + Mobility dhe jo vetëm. Në të njëjtën kohë IAL ka vijuar përpjekjet për bashkëpunime të reja nëpërmjet aplikimit për projekte Erasmus + dhe Horizon 2020. Nga projektet për mobilitetin nuk ka përfituar vetëm personeli akademik i universiteteve bashkëpunuese por dhe studentët e Universitetit Epoka dhe të universiteteve të tjera, në mënyrë specifike për këtë program studimi kanë përfituar gjatë vitit 2021, 2 studentë të Universitetit Epoka dhe 2 studentë të universiteteve partnere përkatësisht: 1 student i Universitetit UBT Kosove dhe 1 student i Universitetit Ancona, Itali.</p> <p><i>DVV Evidencë: RPO Data</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Table 22 Engagement of students in the activities of the unit</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Info on engagement of students in the activities of the unit DVV DVV Evidencë: Student-Staff_Mobilities_v1</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL dhe Departamenti DIK ka mbështetur dhe inkurajuar personelin akademik në punën e tyre kërkimore individuale dhe në grup. Në Universiteti EPOKA zhvillohet lëndë e veçantë, në semestrin e parë të vitit të parë për metodat e kërkimit dhe implementimin e tyre si “CEN 409 Research Methods”. Në të njëjtën kohë nxënësit përdorin metodat e kërkimit në lëndët e tjera për projektet kërkimore të lëndëve dhe punën kërkimore për punimin e diplomës, sic dhe për interesuarit të për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve.</p> <p><i>DVV Evidencë: Syllabus CEN 409-Research Methods</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA mbështet financiarisht dhe inkurajon jo vetëm personelin akademik por edhe studentët të angazhohen në aktivitetet</p>




<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>shkencore bnë IAL, brenda dhe jashtë vendit, kjo në zbatim të nenit 3 të Rregullores “Për kërkimin shkencor” dhe të nenit 6 të udhëzuesit TË IAL “Mbi promovimin e publikimeve shkencore”. Në bashkëpunim me njësitë përkatëse në IAL ka ftuar studentë të IAL apo dhe kërkues të rinj, në dhe jashtë Universitetit EPOKA për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare apo projekte ku është e angazhuar IAL. Kjo evidentohet dhe në pjesëmarrjen e studentëve të Universitetit EPOKA dhe me pagesë dhe me mbështetje financiare në projektet e brendshme të IAL dhe ato ndërkombëtare (Detaje të mëtejshme i gjeni në kriteret 3 dhe 4 të standartit V.6). Mundësitë e aplikimit dhe projektet e kërkimit shkencor në vend dhe jashtë publikohen në faqen Web të IAL nga Zyra e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor. (https://projects.epoka.edu.al/home-guidelines-2354-2374.html)</p> <p>Universiteti EPOKA ka hapur në vitin 2019 thirrjen e 3-të për projekte shkencore që mbështetjet me një fond prej 400 000 ALL për projekt nga IAL dhe aplikantët duhej të ishin doktorantët e regjistruar ne Universitetin EPOKA dhe që nuk kishin përfituar më parë fonde nga thirrjet e mëparshme.</p> <p>Në zbatim të nenit 3 të Rregullores “Për kërkimin shkencor” IAL ka në mission dhe ndjek një politikë promovimi dhe mbështetje në IAL për kërkuesit e rinj shkencor, si personeli i ri i angazhuar si ndihmës në mësimdhënie dhe kandidatët për studimet e doktoraturës, të cilët ftohen të marrim pjesë ose të bëhen pjesë e aktivitetetve shkencore të DIK. IAL e ka të publikuar informacionin për aktivitete shkencore të publikuar në faqen Web të IAL (https://events.epoka.edu.al/).</p> <p><i>DVV Evidencë: Annex 51-Epoka University _ 3rd Call for Internal Scientific Research Projects</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL në përputhje dhe me planin strategjik të tij në funksion të arritjes së objektivave për ofrimin e një edukimi sa më cilësor ka ndjekur një politikë bashkëpunimi me IAL të tjera në vend dhe jashtë me qëllim rritjen e aktiviteteve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Në këtë kuadër bashkëpunime të Universitetit EPOKA me IAL të tjera në kuadër të projekteve Erasmus + dhe HORIZON 2020 inkurojnë dhe mbështesin mobilitetin e studentëve dhe personelit akademik, dhe të programit të studimit Master i shkencave “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni” (Detaje të mëtejshme i gjeni në kriterin 1 të standartit V.7).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL për të rritur profilin ndërkombëtar ka zgjeruar bashkëpunimin me IAL të tjera në kuadër të projekteve ndërkombëtare nën Erasmus + Mobilitet dhe Horizon 2020 (detaje të mëtejshme i gjeni</p>

dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	<p>në kriteret 2 dhe 3 të standartit V.6 dhe kriterin 1 të këtij standarti). Projekti COST Action CA16101 “MULTI-modal Imaging of FORENSIC Science Evidence - tools for Forensic Science “, që zgjati 2017 – 2021, iniciativën ndërkombëtare shkencore ku merr pjesë Universitetit EPOKA me IAL dhe institute shkencore të tjera ndërkombëtare ka në fokus parësor mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, kërkimin shkencor, si dhe mundësi të reja bashkëpunimi ndërkombëtar. Gjatë viteve 2018-2022 nga mobiliteti në IAL të ndryshme ndërkombëtare 6 personel akademik i DIK dhe kanë përfituar mobilitet në Universitetin EPOKA 8 personel akademik nga IAL ndërkombëtare si : Universiteti Debrecen në Hungari, Universiteti Tennessee në Chattanooga, SHBA, Universiteti Ndërkombëtar i Burch, Bosnjë-Hercegovinë etj.</p> <p><i>DVV Evidencë: Student-Staff_Mobilities_v1</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL se në përputhje dhe aktet rregullatore të tij ka ngritur strukturën specifike e institucionit, Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Alumni, që në përputhje dhe me parashikimet në rregulloren e saj informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e IAL, përfshi dhe programin e studimit Master i shkencave “Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”. Kjo zyrë bashkëpunon me Zyrën e Dekanit të studentit , që mban kontakte dhe komunikim ditor me studentët cdo kërkesë e studentëve përcillet për ndjekje tek njësitë përkatëse për çështjet administrative dhe në Departamente për çështjet akademike. Pas trajtimit përgjigja i kthehet studentëve me email nga Dekani i studentit.</p> <p><i>DVV Evidencë: 1-Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 2-Statute-of-Epoka-University</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 10-Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 47-Smart Student Guide 2020-2021</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se IAL ka ngritur strukturat specifike nw institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni që informon në mënyrë të personalizuar në rast kërkese apo nevoje nga studentët nëpërmjet email personal që ata pajisen si studnetë në Universitetin EPOKA; 2. Zyrën e Dekanit të Studentit, që në javën e parë të vitit akademik në bashkëpunim me Fakultetet organizon ditët e Orientimit për studentët e rinj në Universitetin EPOKA me informacion mbi çështjet administrative. 3. Zyra e regjistrimit ofron informacion dhe këshillim për studentët, monitoron progresin e tyre dhe koordinon zgjidhjen e ndonjë problemi që lidhet procesin e mësimdhënies të programit të studimit në bashkëpunim me koordinatorin akademik të DIK. Gjithashtu studentëve ju jepen dhe informacione në formë udhëzuesish apo manualesh të publikuara dhe në faqen ueb përkatëse ("Student Guide"). <p><i>DVV Evidencë: 1-Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 2-Statute-of-Epoka-University</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 10-Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 47-Smart Student Guide 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni ofron shërbimin e këshillimit të karrierës duke mirëpritur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor(krahas personelit akademik), por dhe në orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës, mbështetjen si dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Mund të përmendim angazhimin e plotë të kësaj zyre në informimin e studentëve mbi klubet dhe kalendarin e aktiviteteve studentore, anëtarësimin e tyre në klube dhe pajisjen me kartën përkatëse. Kjo zyrë asiston studentët në programet e praktikës profesionale, që në muajin Mars kur hapen aplikimet për praktikë profesionale deri në përfundimin e tij. Praktika në programin e studimit "Master i shkencave" Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" realizohet gjatë sezonit veror, për një periudhë rreth 1 javore, me një procedure që UE e ka rregulluar dhe ia bën të ditur studentit me anë të një guide me disa formularë që plotësohen prej studentit dhe supervisorit të praktikës.</p> <p>Po nga kjo zyrë informohen studentët/ALUMNI për mundësitë e punësimit në fushën e tyre të studimit nëpërmjet email, Facebook, linkedin apo telefon. Kjo zyrë organizon "Alumni Homecoming", aktivitete sociale</p>

	<p>që i japin të diplomuarve në Universitetin EPOKA mundësi të mbajnë lidhje dhe të krijojnë rrjete profesionale.</p> <p><i>DVV Evidencë: 1-Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 47-Smart Student Guide 2020-2021</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Raportet Vjetore 2016 -2021</i></p>
--	--

<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni, si pjesë të detyrave të saj ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit. Nga kjo zyrë mbahen dhe të dhënat e punësimit real të tyre. Universiteti EPOKA deklaron një shkallë punësimi prej rreth 90% për të diplomuarit e tij, të cilët janë të punësuar në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të punës. Krahas infrastrukturës dhe objekteve të pajisura mirë, Universiteti EPOKA ofron praktika, rrjetëzim, panaire karriere dhe mundësi punësimi për studentët dhe të diplomuarit e tij në bashkëpunim me sektorët dhe industrinë në kuadër të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Kjo zyrë grumbullon, përpunon dhe regjistron të dhënat mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të tyre në raport me programin e studimeve. Këto të dhëna mbahen aktualisht dhe bëhen pjesë e ALUMNI, të cilat kjo zyrë ua vë në dispozicion studentëve, drejtuesve të Institucionit, bizneseve të interesuara për punësim të tyre, me konfirmimin paraprak nga studenti.</p> <p>Kjo zyrë ka krijuar një rrjet me të diplomuarit në rrjetet sociale "EPOKA Alumni Network", ku të gjithë të diplomuarit e interesuar bëhen pjesë dhe ky kanal shërben si një urë komunikimi për cdo aktivitet, njoftim apo mundësi punësimi, krahas komunikimit me emailt e të diplomuarve regjistruar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nga 2010-2021 nga kjo zyrë, e cila përditësohet në vazhdimësi.</p> <p>(https://cpao.epoka.edu.al/)</p> <p>(https://drive.google.com/file/d/1XxEh0IfT7SX3JzXZDFZrH_0LdZaTFys0/view)</p> <p><i>DVV Evidencë: Formati dhe Baza e te Dhenave Alumni</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 78 ALUMNI Form</i></p>
---	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti Epoka, bazuar edhe në skemën organizative, ka të ngritur dhe funksional Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), i cili është i ndërvarur nga senati akademik tek i cili edhe raporton veprimtarinë e tij. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në koordinimin e punës dhe të dhënave nga tre organe vartëse: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Funksionimi i këtyre organeve garanton sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin EPOKA. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse të cilat janë publike dhe të afishuara në faqet ueb përkatëse.</p> <p><i>DVV Evidencë: 1 Organization Scheme</i></p> <p>(http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html) (http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-sigurimit-dokumente-1404.html)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në strukturën organizative të institucionit, ekziston Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) i cili vepron si një organ kolegjal me të paktën 5 (pesë) anëtarë. Gjatë vizitës në institucion u realizua edhe takimi me anëtarë të këtij komisioni. Në përbërjen e këtij komisioni është të paktën një përfaqësues i çdo fakulteti me të paktën gradën shkencore “Doktor”. Në këtë komision përfaqësohet edhe stafi administrativ, studentët, si dhe një ekspert i jashtëm. Bazuar edhe në detyrat dhe rregullat e funksionimit të këshillit studentor, nënkryetari i këshillit studentor është gjithashtu anëtar i këtij komisioni.</p> <p>(https://epoka.edu.al/mat/legal-acts/Statute_of_Student_Council.pdf)</p> <p><i>DVV Evidencë: 1 Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 82 Quality Policy</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 87 EPOKA Quality Assurance Handbook 19 12 2018_final</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) koordinon realizimin e procesit të vetvlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmeve dhe akteve të brendshme rregullatore. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse akredituese (ASCAL). Raportet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë si për institucionin ashtu edhe për program studimi janë publike në faqen ueb të institucionit në linkun (http://iqao.epoka.edu.al/home--external-evaluation-reports-of-ascal-0-1481.html/).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 92

<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) koordinon realizimin e procesit të vetvlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave dhe akteve të brendshme rregullatore. Bazuar në sugjerimet dhe gjetjet e këtij komisioni, hartohen politika të brendshme për rritjen e cilësisë në të gjitha aspektet e jetës akademike, administrative dhe sociale të institucionit dhe stafit, të cilat janë sanksionuar në rregullore dhe politika të brendshme të institucionit për përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit të ofuara që publikohen dhe në faqen web të IAL (http://epoka.edu.al/mat/aeqi/EU-PLC-002-EN Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf).</p> <p><i>DVV Evidencë: 82 Quality Policy</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 9 Directive_Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improvement</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 6 Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 784 766 896">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="766 784 973 896">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="973 784 1181 896">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1181 784 1418 896">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), në rastin e vlerësimit të një programi studimi, koordinon procesin e rishikimit duke filluar në nivel departamenti. Bazuar në ndryshimet e propozuara dhe sugjerimet e paraqitura në nivel departamenti, rezultatet përcillen në njësinë kryesore përkatëse (fakultet). Institucioni ka procedura të qarta për propozime për ndryshime apo rishikime të programeve të studimit ekzistuese. Vendimi i departamentit dhe i Dekanit përkatës, bazuar në procedurat e brendshme, i përcillen Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i cili shqyrton propozimet në përputhshmëri me objektivat e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Nga ana institucionale, propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i përcillen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Mbas shqyrtimit në të gjitha këto komisione, vendimi përfundimtar për aprovimin e ndryshimeve shqyrtohen në Senatën Akademik bazuar në relacionet përkatëse të përcjella nga të gjitha zyrat dhe komisionet e përfshira në këtë proces.</p> <p><i>DVV Evidencë: 6 Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p>

	<p><i>DVV Evidencë: Directive "On academic and administrative performance assessment and quality improvement"</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 80 Curriculum Change Proposal Form</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 2020 07 21_Corrective and-or preventive actions in response to identified issues for each study program</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetvlerësimit, vizitës në institucion, veçanërisht takimi me pedagogët dhe studentët GVJ konstatoi që në mënyrë periodike në fund të çdo semestri studentët plotësonin anketime në lidhje me të gjitha aspektet e jetës akademike dhe jo vetëm në institucion. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe organet nga ai i varur sikurse janë: Zyra e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve, etj kanë mekanizma të qarta për të vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha aspektet akademike, administrative dhe sociale të organizuara nga institucioni dhe për institucionin të identifikuar dhe në manualin e sigurimit të cilësisë. Të dhënat kryesore mblidhen nga proceset e anketimeve të cilat përpunohen për të nxjerrë të dhëna statistikore në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>DVV Evidencë: 87 EPOKA_Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final</i></p> <p><i>DVV Evidencë: form 2020 02 04_Academic Staff Satisfaction Survey_final</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Academic performance</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 80 Curriculum Change Proposal Form</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 2020 07 21_Corrective and-or preventive actions in response to identified issues for each study program</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni kryen analiza semestrale dhe vjetore për ecurinë e programeve të studimit duke i rishikuar ato në kontekstin e kërkesave të tregut. Rezultatet e anketimeve përbëjnë elementët kyç në vlerësimin e një programi studimi. Anketimet që përdoren nuk janë vetëm ato të përpiluara nga studentët aktual, por edhe ato të plotësuara nga ish studentë në kuadër të strukturës alumni. Analiza e anketimeve shërben për vlerësimin dhe orientimin e programit të studimit drejt nevojave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar në varësi të profilit të programit të studimit.</p> <p><i>DVV Evidencë: 76 Student Satisfaction Survey</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 78 Alumni Form</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e brendshme të cilësisë të hartuara nga përpunimi i të dhënave të anketimeve por jo vetëm, analizohen në të gjitha hallkat vendimmarrëse të institucionit. Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike: Departament > Dekanat ></p>

	<p>Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik.</p> <p>Detajet e raporteve janë specifike dhe të përmbledhura sipas hallkës së zinxhirit hierarkik që do të kryej analizën. Vlerësime specifike për lëndë të caktuara apo aspekte të veçanta të tyre, analizohen në detajen në nivel departamenti, analiza dhe vlerësime më specifike në nivel program studimi dhe staf akademik realizohet në nivel dekanati. Hallkat e tjera analizojnë rezultatet e vlerësimit në kontekstin e programit specifik të studimit si dhe në atë të zhvillimit institucional. Raportet e përmbledhura, edhe në kuadër të ruajtjes së privatësisë së të dhënave, bëhen publike të përmbledhura apo të përpunuara në faqen zyrtare të institucionit (http://aeqi.epoka.edu.al/) ku aktualisht janë të publikuara disa prej këtyre vlerësimeve.</p> <p><i>DVV Evidencë: Raporte Vjetore 2016-2021</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit individuale për secilin pedagog/staf akademik përmbajnë të gjithë treguesit e nevojshëm apo parametrat vlerësuese të dobishme për vet stafin që të përmirësojë në vijim. Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion edhe raporte vlerësimi për staf akademik efektiv të këtij programi studimi të realizuar për semestre dhe lëndë të ndryshme për të njëjtin pedagog ku vihej re objektiviteti i analizës dhe raporteve përkatëse që ishin secili i veçantë dhe me pika të ndryshme për tu analizuar lëndë pas lënde.</p> <p><i>DVV Evidencë: Academic performance</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Zyrat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në mënyrë periodike dhe të vazhduar realizojnë vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi. Raportet e hartuara kryesisht në nivel departamentit bazohen në përpunimin e anketimeve studentnotre për çdo lëndë dhe çdo pedagog të angazhuar në procesin e mësim dhënies përkatëse. Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në formë të automatizuar dhe statistikore nga sistemi i menaxhimit të brendshëm elektronik të informacionit EIS. Ndërtimi i raporteve dhe vlerësimeve përkatëse bazohet në direktiva të brendshme të njohura nga të gjithë punonjësit e institucionit.</p>

	<p><i>DVV Evidencë: 19 Directive_Acad _ Admin Perfor Assess _ Quality Improv</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Directive "On academic and administrative performance assessment and quality improvement"</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren institucionale, i gjithë procesi i raportimit, vlerësimit dhe veprimt bazohet në të njëjtën procedurë institucionale dhe nuk është specifike për këtë program studimi. Ndër kriteret specifike që përdoren nga institucioni në vlerësimin e brendshëm është edhe numri dhe cilësia e botimeve/publikimeve shkencore të realizuara nga stafi brenda një periudhe të caktuar vjetore.</p> <p><i>DVV Evidencë: 10 Basic-regulation</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 19 Directive_Acad _ Admin Perfor Assess _ Quality Improv</i></p> <p><i>DVV Evidencë: Directive "On academic and administrative performance assessment and quality improvement"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Burimi parësor i mbledhjes së të dhënave nga institucioni për vlerësimin e të gjithë procesit didaktik bazohet kryesisht në anketime të plotësuara nga studentët por edhe nga vetë stafi akademik. Në rast ankesash apo vlerësime të ulëta të stafit në kriteret e vlerësimit të cilësisë, organet vendimmarrëse kanë mekanizma të përcaktuara qartë për ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë në tërësi. Në rast vlerësimi të ulët në mësimdhënie apo në provime, drejtuesi i njësisë bazë (përgjegjës departamenti) dhe ai i njësisë kryesore (dekan) zhvillojnë vëzhgime në klasë në formë të leksioneve të hapura</p> <p><i>DVV Evidencë: 40 Guideline "On Examinations"</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 41 Directive "On the Functioning of the Exam Board"</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 17 Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 85 Exam Assessment Form</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 86 Examination Period Assessment Form</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit</p>	<p>Institucioni përveç përdorimit të teknikave të anketimeve dhe përpunimit statistikor të tyre, përdor edhe metoda motivuese dhe vlerësuese të stafit akademik në lidhje me performancën e tyre në kërkim shkencor apo angazhimin në projekte dhe administrativ. Pjesëmarrja në aktivitetet e tjera përveç atyre didaktike vlerësohen pozitivisht si motivuese të punës në grup dhe frymës bashkëpunuese brenda institucionit. Kjo vihet re edhe në përfshirjen e studentëve në projektet e institucionit në lidhje me kërkimin shkencor si dhe bashkë autorësinë e publikimeve shkencore të stafit me studentët. Rrjeti Alumni, i ngritur në Universitetin Epoka shërben edhe për të mbledhur të dhëna në lidhje me cilësinë e procesit didaktik por edhe për të kuptuar trendin dhe nevojat e tregut të punës dhe formimin që mungon apo duhet forcuar në aspektin didaktik. Nga IAL</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 96

dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program	hartohen raporte të arritjes të diplomuarve në tregun e punës, që publikohen dhe në faqen Web të IAL si “The Graduate Outcomes in the Labor Market: Ten Years of Achievements” të vitit 2018. (https://drive.google.com/file/d/1XxEh0lft7SX3JzXZDFZrH_0LdZaTFys0/view) <i>DVV Evidencë Minuta takimi EPOKA</i> <i>DVV Evidencë: 78 ALUMNI Form</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) si dhe strukturat nën varësinë e tij, kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë bazuar në rregullore dhe politika të brendshme të cilat janë publike për të gjithë stafin. Për të paraqitur një vlerësim sa më objektiv të cilësisë dhe monitorimit të saj, në përbërjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, është i angazhuar edhe një ekspert publik i cili nuk është pjesë e stafit të Universitetit. Në politikat e rritjes së cilësisë edhe në nivel ndërkombëtar, institucioni motivon zhvillimin e projekteve dhe publikimeve shkencore, për të cilat stafi motivohet edhe me mbështetje financiare. <i>DVV Evidencë: 50 Directive “On the promotion of scientific publications”</i> <i>DVV Evidencë: 87 EPOKA Quality Assurance Handbook 19 12 2018</i> <i>DVV Evidencë: 36 Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimet u vu re se stafi administrativ ka detyra të ndara qartë dhe frymë bashkëpunuese mes tyre. Bazuar në politikat dhe aktet e brendshme rregullatore, detyrat janë të ndara për çdo strukturë përbërëse të institucionit, jo vetëm ato akademik por edhe administrative. <i>DVV Evidencë Minuta takimi EPOKA</i> <i>DVV Evidencë: 10 Basic-regulation</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të	Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ndjek një strukturë hierarkike të vlerësimit dhe analizës së raporteve të hartuara nga njësitë

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 97

<p>studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik. Në këtë formë, të gjitha hallkat administrative, akademike dhe vendimmarrëse janë të përfshira në procesin e vlerësimit të cilësisë. Gjithashtu, në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) ka të paktën një anëtar të çdo njësie kryesore (Fakultet), përfaqësohet stafi administrativ me të paktën dy anëtare, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>DVV Evidencë: 1 Organization Scheme</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 82 Quality Policy</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 87 EPOKA Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit u vlerësua respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtareve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/ udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion. Gjithashtu, në hartimin e raporteve apo edhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në politikat e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>DVV Evidencë Minuta takimi EPOKA</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 82 Quality Policy</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 87 EPOKA Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të syllabuseve të lëndëve. Gjithashtu, si pjesë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë ka në përbërjen e tij një ekspert të jashtëm. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.<i>DVV Evidencë Minuta takimi EPOKA</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 36 Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, kërkesës së dokumentacioneve shtesë por edhe nga lundrimi në faqen web të institucionit, vihet re një transparencë në publikimin e raporteve vlerësuese të përmbledhura [Në web: raportet vjetore nga 2015 deri në 2019]. Gjithashtu institucioni bën publike për stafin dhe të gjithë të interesuarit të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve të pranuar, diplomuar apo larguar për cdo vit dhe për çdo program studimi. Nga IAL janë bërë publike trajnimet e ndryshme të realizuara në kuadër të trajnimeve të stafit dhe ato të realizuara në kuadër të projekteve. <i>GVJ konstaton se nga IAL nuk janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</i></p> <p><u><i>GVJ rekomandon që Universiteti EPOKA të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</i></u></p> <p><i>DVV Evidencë: 16 Epoka University _ academic training on digital education</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Të dhënat e mbledhura dhe përpunuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në tërësinë e tyre publikohen të përmbledhura dhe në formë statistikore, çka garanton mos cënimin e të dhënave personale në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Përdorimi i të dhënave personale të personelit akademik, studentëve apo çdo të dhënë personale, kryhet konform rregulloreve të brendshme institucionale dhe në vartësi të hierarkisë të stafit në institucion. Të dhënat janë të aksesueshme si raporte në sistemin elektronik të brendshëm (EIS) ku qasja në nivele të ndryshme të të dhënave garantohet nga privilegjet gjë gjithsecili ka në këtë sistem, çka garanton privatësinë dhe etikën e përpunimit të këtyre të dhënave (http://epoka.edu.al/mat/Alumni Survey 2017 BAF.pdf)</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në gjetjet dhe raportet e hartuara nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel institucioni po edhe ato të hartuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve etj, analizohen nga organet kolegjiale sikurse janë Senati akademik, Dekanati apo edhe në nivel departamenti. Të gjitha këto hallka vendimmarrëse bazuar në këto raporte, hartojnë plane veprimi të detajuara me afatet kohore të realizimit dhe zyrat dhe stafi përgjegjës për realizimin por edhe ndjekjen dhe raportimin e realizimeve. Nga IAL hartohen raporte të arritjes të diplomuarve në tregun e punës, që publikohen dhe në faqen Web të IAL si “The Graduate Outcomes in the Labor Market: Ten Years of Achievements” të vitit 2018.</p>

	<p>(https://drive.google.com/file/d/1XxEh01fT7SX3JzXZDFZrH_0LdZaTFys0/view)</p> <p>Aktualisht në këtë universitet janë duke u zbatuar një plan-veprimi për përfshirjen e tij në “QS Graduate Employability Rankings 2022 .</p> <p>(http://www.epoka.edu.al/news-epoka-university-successfully-qualifies-for-qs-rankings-2021-as-a-leader-in-international-faculty-5469.html)</p> <p><i>DVV Evidencë: Minuta takimi EPOKA</i></p> <p><i>DVV Evidencë: 15-Framework Strategy and Action Plan 2018-2022</i></p>
--	--

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, Universiteti Epoka organizon evente trajnuese si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ. Gjithashtu vihet re një staf me eksperience dhe i konsoliduar në përbërjen e Njësisë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në këtë njësi ka staf të angazhuar që në vitin akademik 2014-2015 e në vijim sikurse pjesa më e madhe është e angazhuar në këtë funksion që nga viti akademik 2017-2018. <i>Tabelat permbledhese_MSc ECE_sq (Tabela 24)</i></p>
--	---

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti EPOKA, ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e informimit, ndërgjegjësimin të tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pjesëmarrjes së tyre në NJBSC; • pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi; • në javën e orientimit në fillim të vitit akademik • dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetsorëve të studentëve. <p>Por nuk ka organizuar veprimtari periodike trajnuese dhe informuese për këtë qëllim.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL duhet të organizojë veprimtari periodike trajnuese dhe informuese me personelin dhe studentët për t'i informuar për nevojën e ndërgjegjësimin të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit, përfshi programin e studimit “Master i shkencave në ”Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni”.</i></p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit				
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI				
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni", Universiteti "EPOKA"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjedise dhe infrastrukturë moderne në funksion të procesit mësimor dhe shërbimeve të tjera për studentët;
2. Sistemi funksional elektronik të menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit të brendshëm të institucionit por dhe të gjithë aktivitetit didaktik;
3. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik;
4. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit;
5. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit me personel akademik, në përputhje me fushën e ekspertizës, eskperiençë ndërkombëtare dhe nga industria.
6. Fuqizimi i bazës laboratorike bazuar më së shumti, në donacionet e projekteve;
7. Proces selektiv përzgjedhës për studentët në hyrje bazuar në meritë dhe vlerësimi i meritave me bursa akademike e cila rrit cilësinë e studentëve në hyrje;
8. Punësim i lartë si studentëve që ndjekin programin e studimit.
9. Zhvillimi i të gjithë procesit akademik për këtë program studimi në gjuhën angleze iu jep mundesi dhe shanse të larta punësimi dhe ndjekje të studimeve të ciklit të tretë në vend dhe jashtë.
10. Pjesëmarrje në disa projekte kërkimore ndërkombëtare;

Pika të dobëta:

1. Organizimi i kurrikulës së programit të studimit nuk është plotësisht sipas VKM.41 datë 24.01.2018; Nuk jepen kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi të ciklit të dytë, as ndarja në kredite për këtë program sipas kategorive të veprimtarive formuese; Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit.
2. Praktika profesionale nuk përfshihet si lëndë e veçantë në planin mësimor të programit të studimit;
3. Mungesa e orëve laboratorike të përcaktuara në planin mësimor të këtij programi studimi, si formë e veçantë mësimdhënie.



Rekomandime:

1. Institucioni të bëjë organizmi i kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni" në përputhje të plotë me VKM Nr.41 datë 24.01.2018; të bëjë detajimin e planit mësimor me të gjithë format e mësimdhënies që përshkruhen nëpër syllabuset e lëndëve (veçanërisht orët laboratorike). Institucioni të përditësojë literaturën e detyrueshme për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të vazhdojë pasurimi i literaturës fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.
2. "Praktika profesionale" të përfshihet si lëndë e veçantë në planin mësimor të programit të studimit.
3. Institucioni të zvogëlojë ngarkesën e stafit akademik në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore.
4. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit, përveç tarifave studentore.
5. Institucioni të angazhohet për realizimin në mënyrë periodike të studimit të tregut të punës për programin e studimit.
6. Institucioni të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet, në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit. Institucioni të kujdeset që personeli që angazhohet në proceset e vetëvlerësimit të trajnohet në mënyrë periodike.



Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Electronics and Communication Engineering", "EPOKA University"

Strengths and affirmations:

1. Modern facilities and infrastructure in function of the education process and other services for students.
2. Functional electronic information management system in function of the internal administration of the institution but also of all didactic activity.
3. Institution has developed specific mechanisms to support and professional qualification of academic personnel.
4. Institution has signed new collaboration agreement to support academic and professional exchange in country and abroad.
5. The handling of study program courses with academic staff, in accordance with field of expertise, international experience and industry.
6. The strengthening of laboratory infrastructure based mostly on project donations.
7. The selection process for incoming students based on merit and assessment of merits with academic scholarships which increases the quality of incoming students;
8. High employment of this study program students.
9. The development of the entire academic process for this study program in English gives the opportunity and high chances of employment and follow up of third cycle of studies in country and abroad.
10. The contribution in several international research projects.

Weak points:

1. The organisation of study program curriculum is not fully in accordance with PM Decision No.41, date 24.01.2018; The categories of didactic activity that describe this second-cycle study program are not given, nor the division of credits according to the categories of didactic activities. The mandatory literature of the study program, in some subjects is not of the last 5 years.
2. The professional practise is not included as a separate subject in the curriculum of the study program.
3. Lack of laboratory hours in the curriculum of this study program, as a special form of teaching.



Recommendations:

1. The Institution performs the organisation of study program curriculum in accordance with PM Decision No.41, date 24.01.2018; performs the study program description with all the categories of didactic activities that are described in courses syllabus(especially lab hours) this second-cycle study program are not given, nor the division of credits according to the categories of didactic activities; updates the mandatory literature for all subjects of the study program and to follow up the enrichment of physical literature for study program subjects in accordance with updated subject programs.
2. The professional practise to be included as a separate subject in the curriculum of the study program.
3. The Institution reduces the workload of the academic staff in order to guarantee a qualitative teaching and learning.
4. The institution commits to find other sources for financing the study program, in addition to student fees.
5. The institution commits itself to the periodic realization of the study of the labor market for the study program.
6. The institution makes public/publish for the student and interested parties, the held activities, in framework of Internal Quality Assurance of study program; The institution ensures that staff involved in self-assessment processes is trained periodically.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X